REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HAS

PLANI STRATEGJIK I ZHVILLIMIT VENDOR 2026 - 2030



Hartoi

ZYRA PËR ZHVILLIMIN EKONOMIK DHE TURIZMIT

Has, 2025



Të nderuar qytetarë, partnerë dhe miq të Bashkisë Has,

Me kënaqësi ju paraqesim **Planin Strategjik të Zhvillimit Vendor 2026 - 2030**, i cili përfaqëson vizionin tonë të përbashkët për një Has më të zhvilluar, më të qëndrueshëm dhe më të hapur ndaj mundësive të reja. Ky dokument është hartuar në bashkëpunim të ngushtë me sektorët e bashkisë, komunitetin, diasporën dhe partnerët tanë, duke reflektuar nevojat dhe potencialet reale të zonës sonë.

Qëllimi i këtij plani është të shërbejë si një udhërrëfyes i qartë për pesë vitet e ardhshme, duke vendosur prioritetet në bujqësi dhe ekonomi lokale, zhvillimin e turizmit, përmirësimin e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, mbështetjen e të rinjve dhe diasporës, si dhe mbrojtjen e mjedisit tonë të çmuar.

Ne besojmë se ky plan nuk është thjesht një dokument, por një angazhim i përbashkët për ta kthyer Hasin në një vend me më shumë mundësi pune, me shërbime më cilësore, me turizëm të zhvilluar dhe me një komunitet aktiv që kujdeset për të ardhmen.

Ftoj të gjithë qytetarët, bizneset, organizatat dhe partnerët ndërkombëtarë që të bëhen pjesë e zbatimit të këtij plani, sepse zhvillimi i Hasit kërkon përpjekje dhe bashkëpunim të përbashkët.

Me respekt,

Miftar DAUTI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS

Përmbajtia

Hyrje 4

Analiza e Gjendjes Aktuale 5

Profili i Bashkisë 5

Pozita Gjeografike 5

Demografika 6

Profili Ekonomik 7

Analiza SWOT e Bashkisë Has 13

Vizioni dhe Misioni 14

Prioritetet Strategjike 15

Sektori i Burimeve Njerzore 16

Njësia e Auditit të Brendshëm 18

Drejtoria e Administrimit të Pyjeve 20

Sektori Menaxhimit, Mbrojties së Tokës dhe Konsumatorit 29

Shërbimet Publike, Bordi Kullimit, Rrugët 33

Drejtoria e Mbrojties Civile 35

Emergjencat Civile 35

Drejtoria e Arsimit, Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sportit 41

Qendra Kulturore e Fëmijëve 44

Sektori Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit 46

Sektori i Planifikimit të Territorit dhe Urbanistikës 54

Sektori i Taksave dhe Tarifave 59

Sektori Juridik 60

Migracioni dhe Diaspora 62

Zyra për Integrimin Europian 66

Njësia Administrative Gjinaj 68

Njësia Administrative Fajza 69

Figura 1 - Ndarja administrative e Bashkisë Has. 5

Figura 2 - Kromit i vendburimit të kromit Vlahën. 10

Figura 3 - Gurra e fshatit Domaj 12

Figura 4 - Kullë tipike e zonës së Hasit në fshatin Letaj. 13

Figura 5 - Harta e mbulesës së Tokës. 21

Figura 6 - Pamje e Malit të Pashtrikut 49

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HAS

Figura 7 - Harta e pikave Turistike 50

Tabela 1 - Popullsia e Bashkisë Has sipas grupmoshave. 7
Tabela 2 - Grafiku i numrit të popullsisë dhe i familjeve sipas njësive administrative. 7
Tabela 3 - Lloji i aktiviteteve 9
Tabela 4 - Ndarja e tokës sipas kategorisë dhe sipërfaqes që mbulojnë 20
Tabela 5 - Treguesit agro-kimikë të profileve të tokës në Njësinë Administrative Fajzë. 31
Tabela 6 - Analiza SWOT 51
Tabela 7 - Prioritetet strategjike 52

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS

Hyrje

Plani Strategjik i Bashkisë Has 2026 - 2030 është një dokument udhëheqës i zhvillimit vendor, i cili synon të ofrojë një kornizë të qartë për orientimin e politikave dhe projekteve të ardhshme në territorin e Bashkisë Has. Ky plan përmbledh prioritetet strategjike, objektivat e matshëm dhe masat konkrete që do të ndikojnë në zhvillimin ekonomik, social, kulturor dhe mjedisor të komunitetit tonë.

Hyrja e këtij plani bazohet në një analizë të gjendjes aktuale, duke përfshirë trendet demografike, potencialet ekonomike, burimet natyrore dhe trashëgiminë kulturore. Plani synon gjithashtu të identifikojë sfidat dhe mundësitë që paraqiten për Bashkinë Has në pesë vitet e ardhshme, duke vendosur objektiva të qarta për secilin sektor dhe mekanizma të monitorimit dhe vlerësimit të përparimit.

Ky dokument shërben si një udhërrëfyes për vendimmarrjen strategjike, koordinimin ndërsektorial dhe përfshirjen e të gjitha palëve të interesuara, duke garantuar një zhvillim të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës të Hasit deri në vitin 2030 por edhe më tej.



Profili i Bashkisë

Pozita Gjeografike




Figura 1 - Ndarja administrative e Bashkisë Has.

Bashkia e Hasit është sipas ndarjes së re territoriale është një nga 61 bashkitë e Republikës së Shqipërisë. Bashkia e Hasit ka 11687 banorë që jetojnë në Has (deri në vitin 2023 sipas Censusit), dhe një sipërfaqe prej 393 km² dhe kryeqendër qytetin e Krumës.

Hasi është një krahinë etno-gjeografike me kufij të përcaktuar shumë qartë, i rrethuar pothuajse rreth e qark i gjithë Hasi me lumenjë në mes ngrihet madhështor mali i Pashtrikut me lartësi 1989 m mbi nivelin e detit. Në veri dhe në lindje, Drini i Bardhë dhe dega e tij Ereniku që e ndajnë nga Krahina e Rekës dhe Podrimës (Rrafshi i Drinit). Në jug dhe në perëndim kufizohet me krahinën e Lumës dhe Malezиut me të cilat i ndan Drini i Bardhë dhe i bashkuar dhe sot liqeni i Fierzës, ndërsa në veri-perëndim përroi i Skatinës e ndan nga Butyçi i rrethit të Tropojës.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS

Relievi: Territori i Bashkisë Has është kryesisht malor dhe kodrinor. Zona është e karakterizuar nga male të larta dhe lugina të thella, duke e bërë atë një zonë të përshtatshme për aktivitete të jashtme dhe për përdorimin e burimeve natyrore.

Lumenjtë dhe Ujërat: Në këtë rajon kalojnë disa lumenj të vegjël dhe përrenj, të cilët janë pjesë e sistemit hidrografik të lumi i Drinit dhe i lumenjve të tjerë që derdhen në të (lumi Krumës, lumi Vlahnës, lumi Rosmanit, lumi Leshnicës etj,). Ujërat janë të rëndësishëm për bujqësinë dhe përdorimin e ujit në këtë rajon malor. Malësinë e Hasit e drenojnë (lumi) përroi i Krumës, Vlahnës, Rosmanit, Leshnicës, Vranishtit dhe rrjedha e sipërme e përroit të Skatinës. Mes objekteve artificiale ujore përmendim ujëmbajtesit dhe kanalet ujitës të ndërtuar kryesisht gjatë gjysmës së dytë të shek. XX. Numërohen 20 të tillë. Ato janë të vegjël dhe ndër to përmendim: rezervuari i Planit (llakajve), Dobrunës, Qarrit etj. Pas viteve '90 rrjeti ujitës u dëmtua dhe janë të pakët objektet ujitës që vazhdojnë të egzistojnë sot për të të cilët vazhdimisht punohet për ti mirmbajtur dhe për të rritur kapacitetn e tyre ujmbledhës.

Klima: Malësia e Hasit bën pjesë në klimën mesdhetare paramalore veriore. Hasi dallohet për temperatura paramalore e cila dallohet për verën e freskët dhe dimër të lagësht e të ftohtë më ngrica e dëborë. Temperatura mesatare vjetore arrinë 11.4 ^{0}c (Krumë). Në shpërndarjen mujore të temperaturave vërehet se janari është muaji më i ftohtë me vlera mesatare zakonisht 0.4^0 C - 0.9 ^{0} C. Minimumet absolute të kësaj zone takohen në muajin janar, kur kanë arritur në -19^{0}C për stacionin e Krumës, por shtrirja e tyre kap gjithë periudhën tetor - prill. Temperaturat më të larta takohen gjatë muajit korrik e gusht me shumë pak ndryshime 21^{0}C dhe 22^{0}C për stacionin e Krumës. Maksimalja absolute është shënuar në qytetin e Krumës në muajin korrik me 38.6 ^{0}C.

Flora dhe Fauna: Për shkak të terrenit malor dhe klimës, flora dhe fauna e këtij rajoni janë të pasura. Zona është e mbuluar me pyje, bari dhe bimësi të tjera që mbështesin një larmi specie të kafshëve dhe bimëve.

Burime Natyrore: Në rajon ndodhen disa burime ujore dhe minerale të rëndësishme, që kontribuojnë në ekonominë lokale. (vendburimi kromit Vlahën,Perollaj,Maç etj,).

Popullsia dhe Fshatrat: Bashkia Has përbëhet nga disa fshatra (30 fshatra + një qytet) që janë shpërndarë nëpër këtë terren malorë, dhe shumë nga ata kanë një strukturë të karakterizuar nga zhvillimi tradicional dhe mënyra e jetesës rurale.

Demografika


Popullsia në Bashkinë e Hasit është homogjene. Bashkia ka nën administrimin e vet 30 fshatra, ndër të cilët 12 në Golaj, 8 në Fajze, 6 në Gjinaj dhe 4 fshatra + qyteti në Krumë. Në vijim, Bashkia e Hasit numëron 5,322 familje, ndër të cilat 2,074 në Golaj, 1,758 në Krumë, 1,048 në Fajze dhe 442 në njësinë Gjinaj. E veçantë për këtë bashki është se popullsia e saj është tërësisht rurale. Për më tepër, Bashkia e Hasit është karakterizuar gjithmonë nga emigracioni. Një pjesë e të rinjëve kalojnë kufirin rregullisht për punësim në vendet e Bashkimit Europian apo në Kosovë.Shumica e të rinjëve lëvizin për ndjekur arsimin e lartë drejt kryeqytetit, për këtë arsye, popullsia përbëhet

më së shumti nga mosha e tretë. Sipas Censusit të vitit 2023 bashkia numëron 11,687 banorë që jetojnë në Has, ndërsa sipas Gjendjes Civile kjo bashki ka një popullsi prej 21,764 banorësh. Nga ky numer, 7 554 persona jane te moshave 15 deri ne 65 vjec. Trendi i përgjithshëm tregon për një tkurrje të popullsisë çdo vit dhe më shumë

Tabela 1 - Popullsia e Bashkisë Has sipas grupmoshave.

Popullsia Has	0-14	15-64	65+
Gjithesej	2 641	7 554	1 489
Meshkuj	1 415	3 565	704
Femra	1 226	3 989	785

Tabela 2 - Grafiku i numrit të popullsisë dhe i familjeve sipas njësive administrative.



Profili Ekonomik

Bashkia Has, e vendosur në verilindje të Shqipërisë, është një zonë me karakteristika kryesisht rurale dhe bujqësore, me një popullsi relativisht të vogël. Ky rajon kufizohet me Kosovën, gjë që ka ndikuar në zhvillimin e tij ekonomik, sidomos në lidhje me tregtinë ndërkufitare. Bashkia Has ka një ekonomi kryesisht rurale, të mbështetur në bujqësi, blegtori dhe tregti ndërkufitare me Kosovën. Këto sektorë përbëjnë burimet kryesore të të ardhurave për popullsinë lokale.

Me një popullsi të shpërndarë në zonat fushore dhe malore, ky rajon ofron mundësi për zhvillim në sektorë të caktuar.

1. **Bujqësia dhe Blegtoria**

- **Bujqësia** është një shtyllë kryesore e ekonomisë lokale. Toka është përdorur kryesisht për prodhimin e drithërave, perimeve dhe frutave. Klima dhe relievi malor ofrojnë kushte të përshtatshme për rritjen e kulturave tradicionale.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HAS

- **Blegtoria** është gjithashtu një sektor i rëndësishëm. Banorët lokalë rrisin kryesisht gjedhë, dele, dhe dhi (dhia e hasit njihet për cilësin e lartë të mishit dhe të nënprodukteve të qumështit), duke prodhuar qumësht, mish dhe nënprodukte të tjera blegtorale. Tradita e përpunimit të produkteve blegtorale është e theksuar, megjithëse në shumicën e rasteve bëhet në mënyrë artizanale.

2. Tregtia ndërkufitare

- Afërsia e Hasit me kufirin e Kosovës ka qenë një faktor i rëndësishëm ekonomik. **Tregtia ndërkufitare** ka krijuar mundësi për shkëmbimin e produkteve bujqësore dhe të konsumit. Disa banorë të Hasit shfrytëzojnë këtë afërsi për të kryer aktivitete tregtare në Kosovë, si dhe për të importuar dhe eksportuar mallra.

3. **Remitancat dhe diaspora**

- Një pjesë e madhe e popullsisë së Hasit ka emigruar, kryesisht drejt vendeve të Evropës Perëndimore, si Mbretëria Bashkuar, Gjermania, Zvicra dhe Italia. **Remitancat** janë një burim i rëndësishëm të ardhurash për shumë familje në Has. Ato përdoren kryesisht për përmirësimin e kushteve të jetesës, ndërtimin e shtëpive dhe investime të vogla në ekonomi familjare.
- Remitancat kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në mirëqenien e familjeve, por nuk janë përdorur në mënyrë të gjerë për investime strategjike që do të krijonin punësim të qëndrueshëm dhe zhvillim ekonomik afatgjatë.

4. Turizmi

- **Turizmi** nuk është ende shumë i zhvilluar në Bashkinë Has, megjithatë zona ka një potencial të konsiderueshëm për zhvillimin e turizmit natyror dhe kulturor për të cilin po punohet për ta ngritur në nivelet e duhura. Male, lumenjë, dhe pyje të dendur ofrojnë një peizazh të bukur që mund të tërheqë turistë të interesuar në ecje, kamping dhe eko-turizëm.

5. **Infrastruktura**

- **Infrastruktura** mbetet një nga sfidat kryesore për zhvillimin ekonomik të Hasit. Rrugët viteve të fundit rikonstruktuar dhe janë asfaltuar rrugë të reja, veçanërisht në zonat rurale dhe malore, duke sjellë një qasjen më të lehtë në tregje dhe shërbime. Përmirësimi i rrugëve dhe lidhja më e mirë me rrjetin kombëtar të transportit është një hap i madh për rritjen e mundësive tregtare dhe turistike.
- Sistemi i furnizimit me ujë dhe energji elektrike është përmisuar, duke krijuar mundësi për zhvillimin e sektorëve si bujqësia e përparuar dhe turizmi por gjithmon ka hapsira për përmisime në këto dy sektorë.

6. **Punësimi dhe sfidat sociale**

- **Papunësia** mbetet një problem madhor për Hasin. Mundësitë për punësim jashtë bujqësisë janë të kufizuara, por afersia me qytetet si Gjakova, Prizereni, Kukësi iu ka dhënë mundësi për punësim

banorëve. Një pjesë e mirë e popullsisë mbështetet në aktivitetet e vogla tregtare ose në ndihmat financiare nga jashtë.

- Një mungesë e madhe në aftësitë profesionale dhe mungesa e arsimit profesional të zhvilluar kanë ndikuar që të rinjtë të kenë pak mundësi për të gjetur punësim të qëndrueshëm, duke i shtyrë ata të emigrojnë.

7. **Potencialet për zhvillim**

- **Zhvillimi bujqësor dhe blegtoral** mund të përmirësohet përmes investimeve në teknologji moderne dhe krijimit të kooperativave bujqësore për të përmirësuar qasjen në tregje.
- **Turizmi** mbetet një sektor me potencial të madh. Me investime të vogla në infrastrukturën e qëndrueshme dhe promovim, Bashkia Has po punonë në zhvillillimin e turizmit natyror dhe kulturor.
- **Tregtia ndërkufitare** po zgjerohet me përmirësimin e lidhjeve infrastrukturore dhe mbështetjen e politikave që lehtësojnë shkëmbimin ndërkufitar.

Bizneset në numrin më të madhë janë të përqëndruara kryesisht në qytet në përjashtim të kompanive që operojnë në industrin e nxjerrjes së mineraleve.

Tabela 3 - Lloji i aktiviteteve

BUJQËSI DHE BLEKTORI
INDUSTRIA USHQIMORE
INDUSTRIA MINERARE
NDËRTIMTARI
TREGTI
AKTIVITET FINANCIAR DHE SIGURIMESH

Bizneset kryesore që mbështesin ekonominë e Hasit janë: **bujqësia dhe blegtoria, tregtia ndërkufitare, dyqanet dhe shërbimet e vogla, transporti dhe logjistika**, dhe **remitancat** nga diaspora. Këto sektorë krijojnë punësim dhe të ardhura për komunitetin lokal.

Për të mbështetur bizneset në Bashkinë Has, po ndiqen këto drejtime:

- **Përmirësimi i infrastrukturës** - Investime në rrugë dhe energji për lehtësimin e aktivitetit ekonomik.
- **Zhvillimi i tregtisë ndërkufitare** - Lehtësira për tregti me Kosovën dhe shtetet tjera fqinjë.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HAS

- **Mbështetje për bujqësinë dhe blegtorinë** - Ofrimi i teknologjive moderne dhe subvencioneve për fermerët.
- **Nxitja e turizmit** - Promovimi i turizmit natyror dhe kulturor për të tërhequr vizitorë.
- **Përkrahja e bizneseve të vogla** - Lehtësimi i procedurave dhe ofrimi i granteve apo kredive për bizneset lokale në bashkpunim me donatorë.

Burimet Natyrore

Mineralet

Mineralet metalike:

Zona e Hasit ka qenë historikisht e njohur për depozitat e pasura me minerale, veçanërisht kromë dhe bakër. Minierat e kromit dhe bakrit në këtë rajon kanë qenë aktive në të kaluarën, dhe megjithëse aktivitetet minerare janë zbehur, ato mbeten një burim i vlefshëm natyror. Potenciali për shfrytëzim të mëtejshëm të këtyre mineraleve ekziston, veçanërisht me avancimin e teknologjisë së shfrytëzimit dhe rikuperimit të burimeve natyrore.

Mineralet jometalike:

Përveç mineraleve metalike, në Hasi ka edhe depozita minerale jometalike që përdoren në industrinë e ndërtimit, si p.sh. gëlqerorët dhe argjilat. Këto burime mund të jenë të rëndësishme për ndërtimin e infrastrukturës lokale dhe për eksport.



Figura 2 - Kromit i vendburimit të kromit Vlahën.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS

Rrethi i Hasit ka pasuri të shumta minerare përbëhet nga shkëmbinj gëlqerorë, magmatikë dhe metamorfikë kjo lidhet me pasuritë e shumta minerare në këtë zonë. Sasia më e madhe e kromit njihet në Vlahën dhe vendburimi lokalizohet në masivin ofiolitik Tropojë - Has duke u lidhur me vendburimet e Kam - Tropojës për nga lokalizmi. Vendburimi xeheror i Vlahnes njihen 2.5 milion ton xehe kromit, por rreth 0.2 milion ton tashmë janë nxjerrë. Është formuar brenda harzburgitit të varfëruar me lente duniti të bollshme dhe të trasha.18% - 43%. Miniera e Qafë Perollit njihet për një sasi prej 560000 ton Cr me pastërti 26% - 40%. Sipas studimeve në Golaj gjenden rreth 4.5 milion ton rezerva bakër të pashfrytëzuara edhe për shkak të mosfunksionimit të minierës. Fshatrat Vranisht, Vlahën dhe së fundmi Cahan njihen për nëntokë të pasur me Fe-Ni.

Pyjet dhe Bimësia

Hasi ka sipërfaqe të mëdha të mbuluara me pyje, të cilat janë një burim natyror kyç për rajonin. Pyjet përmbajnë lloje të ndryshme drurësh, përfshirë pishën, bredhin, lisin dhe gështenjën. Këto drurë përdoren për dru zjarri dhe për prodhim industrial (si për përpunim druri).

Biodiversiteti:

Pyjet e Hasit ofrojnë një shtëpi për një shumëllojshmëri speciesh të egra, përfshirë kafshë të rralla dhe të mbrojtura, si ujku, ariu dhe kaprolli. Ky biodiversitet natyror është një pasuri e madhe ekologjike dhe krijon potencial për zhvillimin e turizmit natyror.

Hidrografia

Lumenjtë dhe burimet natyrore:

Hasi është i pasur me burime ujore natyrale, duke përfshirë lumenj dhe përrenj të cilët furnizojnë ujë për bujqësi dhe për përdorim të përditshëm. Ndër lumenjtë më të njohur në zonë është Drini i Bardhë, i cili është një nga burimet kryesore të ujit në veri të Shqipërisë.

Liqenet e vogla dhe ujëmbledhësit:

Në Hasi mund të gjenden liqene të vegjël natyralë dhe rezervuarë, të cilët shfrytëzohen për vaditje dhe për mbajtjen e burimeve ujore gjatë muajve të thatë. Ka mundësi për shfrytëzim më të mirë të këtyre burimeve për qëllime bujqësore dhe energjetike, siç është rezervuari i "Planit".

Potenciali hidroenergjitik:

Lumenjtë dhe burimet natyrore të Hasit ofrojnë mundësi për zhvillimin e projekteve të vogla hidroenergjitike, (Rosmani, Vlahna), duke prodhuar energji të pastër dhe të rinovueshme për komunitetin lokal dhe për eksport në rrjetin kombëtar.

Lumi Krumës

Ai e ka origjinën në burimin e madh karstik të Vrellës dhe derdhet në Liqenin e Fierzës. Ky lumë ka një sipërfaqe të pellgut ujëmbledhës prej 227 km^2 dhe një gjatësi prej 26.5 km. Vlerat maksimale kryesore të prurjeve i gjejmë në muajin dhjetor me 13% të rrjedhjes së përgjithshme vjetore si

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS

pasojë e reshjeve të shiut ndërsa vlerat maksimale të tjera i gjejmë në muajin shkurt si pasojë e burimit të fuqishëm të Vrellës (Krumës). Vlerat minimale kryesore i gjejmë në muajin gusht me 0.53 m3 /sek ose 2% të rrjedhjes së përgjithshme vjetore si pasojë e reshjeve të pakta të shiut dhe avullimit të fuqishëm dhe për shkak të mungesës së formacioneve ujëmbajtëse.




Figura 3 - Gurra e fshatit Domaj

Turizmi Natyror, Kulturor dhe Peisazhet

Peisazhi malor:

Hasi është një **nga** rajonet më të bukura në Shqipëri për nga natyra e tij e paprekur dhe peisazhet malore. Malet e larta, luginat e thella dhe pyjet e dendura krijojnë një peizazh spektakolar që është i përshtatshëm për turizëm natyror, hiking dhe kamping.

Turizmi i aventurës:

Me terrene sfiduese dhe natyrë të paprekur, Hasi ofron mundësi për zhvillimin e turizmit të aventurës, përfshirë ecje në male, alpinizëm dhe çiklizëm malor. Zhvillimi i infrastrukturës për këto aktivitete mund të sjellë përfitime të mëdha ekonomike për komunitetin lokal.

Trashëgimia kulturore:

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS

Përveç burimeve natyrore, Hasi ka edhe një trashëgimi të pasur kulturore dhe historike që mund të jetë tërheqëse për turistët, si rrënojat e kalave dhe vendbanimeve të vjetra, si dhe traditat lokale të përpunimit të artizanateve dhe muzikës tradicionale.



Figura 4 - Kullë tipike e zonës së Hasit në fshatin Letaj.

Analiza SWOT e Bashkisë Has

Forcat (Strengths)

- Pozicion gjeografik strategjik pranë Kosovës dhe rrugëve ndërkufitare.
- Burime natyrore të pasura: pyje, lumenj dhe tokë bujqësore.
- Trashëgimi kulturore dhe historike e pasur (kulla, vallet dhe traditat).
- Ekonomi lokale e bazuar në bujqësi, blegtori dhe artizanat.
- Populsi me lidhje të forta komunitare dhe tradita mikpritjeje.

Dobësitë (Weaknesses)

- Infrastruktura rrugore dhe shërbimet publike të mangëta në disa zona rurale, sidomos në njehsin administrative Gjinaj.
- Emigracioni i të rinjve dhe mungesa e forcës punëtore të kualifikuar.
- Pak diversifikim ekonomik dhe mbështetje e limituar për biznesin e vogël.
- Turizmi i pak zhvilluar dhe mungesa e shërbimeve moderne turistike.
- Kapacitete të kufizuara të sektorëve për menaxhim të qëndrueshëm të burimeve natyrore.

Mundësitë (Opportunities)

- Zhvillimi i turizmit natyror dhe kulturor (Mali i Pashtrikut, itinerare kufitare).
- Aplikimi për fonde kombëtare dhe ndërkombëtare për projekte zhvillimi.
- Promovimi i produkteve tradicionale dhe zhvillimi i kooperativave bujqësore.
- Përdorimi i energjive të rinovueshme (mini-hidro, fotovoltaik).
- Bashkëpunimi me diasporën dhe investitorë të huaj.

Kërcënimet (Threats)

- Migracioni i të rinjve dhe tkurrja e popullsisë në disa zona.
- Ndryshimet klimatike që ndikojnë në bujqësi dhe pyje.
- Konkurrenca nga rajone të tjera për zhvillim turistik dhe investime.
- Kufizimet buxhetore të Bashkisë dhe mbështetja e pamjaftueshme e sektorëve lokalë.
- Rreziqet e degradimit të burimeve natyrore pa menaxhim të qëndrueshëm.

Vizioni dhe Misioni

Vizioni 2030

Vizioni për Bashkinë Has është:

"Një Bashki e zhvilluar, e qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, ku ekonomia lokale lulëzon, turizmi natyror dhe kulturor është i zhvilluar, infrastruktura dhe shërbimet janë të modernizuara, dhe komuniteti i përfshirë aktivisht në vendimmarrje dhe ruajtjen e mjedisit."

Ky vizion reflekton dëshirën për:

- Zhvillim ekonomik dhe punësim të qëndrueshëm.
- Përdorim të mençur të burimeve natyrore.
- Përmirësim të cilësisë së jetës për qytetarët.
- Promovim të trashëgimisë kulturore dhe turizmit.

Misioni

Misioni i Bashkisë Has është:

"Të krijojë kushte të favorshme për zhvillim ekonomik dhe social, të mbështesë iniciativat e komunitetit dhe të sektorëve, të ruajë burimet natyrore dhe trashëgiminë kulturore, dhe të forcojë bashkëpunimin me partnerët lokalë, kombëtarë dhe ndërkombëtarë për të arritur një zhvillim të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës."

Pikat kryesore të misionit:

- Përkrahja e ekonomisë lokale dhe bujqësisë.
- Zhvillimi i turizmit natyror dhe kulturor.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA HAS

- Përmirësimi i infrastrukturës dhe shërbimeve publike.
- Pjesëmarrja aktive e qytetarëve dhe komunitetit.
- Ruajtja e mjedisit dhe përdorimi i qëndrueshëm i burimeve.

Prioritetet Strategjike

Për periudhën 2026 - 2030, Bashkia Has ka përcaktuar **prioritetet strategjike kryesore**, të cilat do të shërbejnë si udhërrëfyes për të gjitha politikat, investimet dhe projektet në nivel lokal. Këto prioritete synojnë të sigurojnë zhvillim të qëndrueshëm, gjithëpërfshirës dhe të bazuar në potencialet reale të Bashkisë dhe komunitetit të saj.

1. Zhvillimi Ekonomik dhe Punësimi

- Mbështetja e bujqësisë dhe blegtorisë me teknologji moderne dhe tregje të reja.
- Nxitja e agroturizmit, turizmit malor dhe kulturor.
- Krijimi i kushteve për biznese të vogla dhe start-up-e vendore.
- Përdorimi i potencialit të diasporës për investime dhe zhvillim.

2. Infrastruktura dhe Shërbimet Publike

- Përmirësimi i rrjetit rrugor dhe lidhjeve me zonat kufitare.
- Investime në ujësjellës, kanalizime dhe menaxhim të mbetjeve.
- Zhvillimi i infrastrukturës energjetike dhe dixhitale.
- Përmirësimi i shërbimeve sociale dhe administrative për qytetarët.

3. Arsimi, Rinia dhe Sporti

- Përmirësimi i infrastrukturës arsimore dhe pajisja e shkollave me kushte moderne.
- Zhvillimi i programeve për rininë, me fokus në inovacion dhe punësim.
- Investime në terrene sportive dhe aktivitete rinore.
- Nxitja e edukimit për integrimin europian dhe aftësitë digjitale.

4. Kultura, Trashëgimia dhe Turizmi

- Restaurimi dhe promovimi i monumenteve të kulturës dhe kullave tradicionale.
- Organizimi i festivaleve kulturore dhe aktiviteteve të trashëgimisë.
- Krijimi i guidave turistike dhe rrjeteve të informacionit turistik.
- Promovimi i Malit të Pashtrikut dhe resurseve natyrore si atraksione kryesore.

5. Mjedisi dhe Zhvillimi i Qëndrueshëm

- Mbështetja e projekteve të gjelbra dhe energjisë së rinovueshme.
- Rehabilitimi i pyjeve, kullotave dhe burimeve ujore.
- Zbatimi i planit të menaxhimit të mbetjeve urbane.
- Edukimi i komunitetit për mbrojtjen e mjedisit.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA HAS

6. Integrimi Europian dhe Bashkëpunimi Ndërkufitar

- Rritja e përfitimit nga fondet IPA dhe programet e BE-së.
- Forcimi i marrëdhënieve me komunat në Kosovë dhe rajon.
- Organizimi i projekteve të përbashkëta ndërkufitare për turizëm dhe zhvillim ekonomik.
- Ngritja e Zyrës së Integrimit Europian si strukturë kryesore për projektet ndërkombëtare.

7. Migracioni dhe Diaspora

- Mbajtja e lidhjeve të forta me diasporën hasjane.
- Përfshirja e diasporës në zhvillimin lokal përmes investimeve dhe projekteve sociale.
- Krijimi i një platforme digjitale për komunikim dhe shërbime për diasporën.
- Organizimi i aktiviteteve kulturore dhe ekonomike me pjesëmarrjen e mërgatës.

Zbatimi i prioriteteve strategjike ka si qëllim kryesor:

- **Përmirësimin e infrastrukturës dhe shërbimeve publike**, duke garantuar akses më të mirë dhe cilësi të lartë për qytetarët.
- **Zhvillimin ekonomik lokal dhe mbështetjen e bujqësisë, blegtorisë dhe biznesit të vogël**, për të krijuar vende pune dhe për të rritur mirëqenien e komunitetit.
- **Promovimin e turizmit natyror dhe kulturor**, duke shfrytëzuar burimet natyrore dhe trashëgiminë kulturore për zhvillim ekonomik dhe përmirësim të imazhit të Bashkisë Has.
- **Ruajtjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore**, duke siguruar balancën midis zhvillimit dhe mjedisit.
- **Pjesëmarrjen aktive të komunitetit dhe koordinimin ndërsektorial**, për të garantuar transparencë, efikasitet dhe përfshirje të të gjitha palëve të interesuara në proceset vendimmarrëse.

***Prioritetet janë ndarë dhe analizuar sipas sektorëve.**

Sektori i Burimeve Njerzore

Hyrje

Plani Strategjik i Burimeve Njerëzore është një dokument afatmesëm që ka për qëllim të sigurojë përputhjen ndërmjet objektivave të zhvillimit të Bashkisë Has dhe kapaciteteve njerëzore që i nevojiten për realizimin e tyre.

Vizioni dhe Objektivat

Vizioni:

- Të ndërtojmë një administratë bashkiake profesionale, efikase dhe të përgjegjshme për të përmbushur nevojat e komunitetit të Hasit.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HAS

Objektivat Strategjike:

1. Rritja e kapaciteteve profesionale të stafit.

2. Zhvillimi i një sistemi transparent dhe meritokratik rekrutimi.

3. Përmirësimi i performancës dhe vlerësimit të punonjësve.

4. Modernizimi i procesit të menaxhimit të Burimeve Njerëzore.

5. Rritja e motivimit, përfshirjes dhe kënaqësisë në punë.

Analiza e Situates Aktuale(SWOT)

- **Struktura Organizative** është e përbërë nga nëpunës civil dhe jo civil në funksione administrative, teknike dhe shërbimesh publike.

PIKAT E FORTA	PIKAT E DOBËTA	MUNDËSITË	KËRCËNIMET
- Staf me experiencë -Kulturë Organizative - Proceset bazë HR të standartizuara	-Mungesë trajnimesh të vazhdueshme -Mungesë e sistemit dixhital HR	-Trajnime Online dhe teknologjia HR. -Partneritete me institucione, organizata, agjensi të tjera	- Largimi i stafit drejt sektorit privat -Ndryshime në tregun e punës

Prioritetet dhe Masat Kryesore

Nr.	PRIORITETI	MASAT KRYESORE
1	Rekrutimi dhe përzgjedhja	Hartimi i një kalendari vjetor për rekrutime. Përgatitja e profileve të punës dhe kërkesave për çdo pozicion
2	Trajnimi dhe zhvillimi	Bashkëpunim me ASPA për trajnimet. Programe trajnimi për drejtuesit dhe specialistët
3	Performanca dhe Zhvillimi	Zbatimi i sistemit të vlerësimit sipas ligjit nr.152/2013. Përdorimi i indikatorëve të matshëm të performancës
4	Motivimi dhe mirëqenia	Hartimi i një sondazhi vjetor për klimën në punë. Rritja e përfshirjes së punonjësve nësve në vendimarrje.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS

5	Dixhitalizimi	Përdorimi i sistemit elektronik për menaxhimin e dokumentacionit të personelit. Automatizimi i procesit të vlerësimit të performancës.

Monitorimi dhe Vlerësimi

- Raporte mujore për progresin e objektivave.
- Vlerësime vjetore të ndikimit të planit strategjik.
- Sondazhe për kënaqësinë dhe angazhimin e punonjësve.

Njësia e Auditit të Brendshëm

Misioni i njësis së auditit të brendshëm

Misioni i auditimit të brendshëm është të japë siguri të arsyeshme për titullarin e njësisë publike në mënyrë të pavarur dhe objektive, këshilla për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësinë e sektorit publik.

Vlerat themelore

Njësia e Auditimit të Brendshëm ne Bashkinë Has synon të udhëhiqet nga këto vlera themelore:

Integriteti - Të veprojë me ndershmëri, drejtësi dhe paanshmëri, duke ruajtur konfidencialitetin dhe besimin e publikut.

Pavarësia dhe Objektiviteti - Të sigurojë vlerësime të pavarura dhe objektive, të bazuara në evidenca.

Profesionalizmi - Të respektojë standardet profesionale, të zhvillojë kapacitetet dhe të ofrojë shërbime me cilësi të lartë.

Besueshmëria - Të ndërtojë dhe ruajë besimin tek drejtuesit, punonjësit dhe palët e interesit përmes komunikimit të qartë dhe transparencës.

Vlera e Shtuar - Të kontribuojë në përmirësimin e proceseve, forcimin e kontrollit të brendshëm dhe përdorimin efikas të burimeve publike.

Bashkëpunimi - Të punojë në frymë partneriteti me të gjitha strukturat për të promovuar kulturën e qeverisjes së mirë dhe menaxhimit të rrezikut.

Objektivat Strategjikë

Objektivi i Njësisë së Auditimit të Brendshëm, Bashkia Has është të sigurojë një auditim të brendshëm të pavarur, objektiv dhe efektiv, që kontribuon në përmirësimin e qeverisjes vendore, forcimin e kontrollit të brendshëm dhe menaxhimin e rrezikut.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HAS

Analiza SWOT

ANALIZA SWOT	
Forcat (Strengths) • **Staf i kualifikuar dhe me përvojë.** • **Pavarësi funksionale e garantuar me ligj.** • **Mbështetje nga drejtuesit e Bashkisë për zhvillim profesional.**	**Dobësitë (Weaknesses)** • Kapacitet i kufizuar njerëzor (numër i vogël audituesish). • Mungesë e mjeteve të avancuara IT për auditim. • Mungesë e një Komiteti Auditimi.
Mundësitë (Opportunities) • **Trajnime dhe certifikime të mbështetura nga institucionet qendrore.** • **Përdorimi i teknologjisë për auditim më efektiv.** • **Rritja e bashkëpunimit me auditues të jashtëm dhe njësitë e tjera.**	**Kërcënimet (Threats)** • Ndryshime të mundshme në kuadrin ligjor ose institucional. • Mungesa e burimeve të mjaftueshme financiare për teknologji dhe trajnim. • Ndikim i mundshëm politik ose ndërhyrje në pavarësinë e auditimit.

Aktivitetet Kryesore

Hartimi dhe miratimi i Planit Strategjik dhe Planit Vjetor të Auditimit, bazuar në vlerësimin e rrezikut.

Zbatimi i planit përmes kryerjes së auditimeve sipas fushave të përcaktuara dhe drejtorive apo sektorëve përkatës të Bashkisë Has.

Përgatitja e raporteve për çdo auditim të kryer dhe hartimi i raportit vjetor të aktivitetit të Njësisë së Auditimit të Brendshëm.

Ndjekja dhe monitorimi i zbatimit të rekomandimeve të Njësisë së Auditimit të Brendshëm dhe të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Raportimi periodik në Drejtorinë e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, Ministria e Financave mbi gjetjet dhe masat e marra.

Rezultatet e Pritshme

Auditime me impakt më të lartë për përdorimin efektiv të fondeve publike.

Staf më i kualifikuar dhe i motivuar.

Rritje e nivelit të zbatimit të rekomandimeve tw dhwna nga Njwsia e Auditimit tw Brendshwm.

Përdorim më i mirë i teknologjisë për auditim dhe raportim.

Besueshmëri më e lartë nga strukturat drejtuese dhe qytetarët

Monitorimi dhe Vlerësimi.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HAS

Përgatitja e raporteve të progresit vjetor të Njësisë së Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Has.

Vetëvlerësime të rregullta të përputhshmërisë me standardet profesionale të Auditimit të Brendshëm.

Vlerësime të jashtme çdo 5 vjet sipas ligjit për auditimin e brendshëm.

Drejtoria e Administrimit të Pyjeve

Hyrje

Bashkia Has shtrihet në një sipërfaqe prej 34,451.16 hektarësh, nga të cilat 69% përbëhen nga pyje dhe 16% nga kullota dhe livadhe. Ky potencial natyror përbën një burim të rëndësishëm ekologjik, ekonomik dhe social për komunitetin lokal, por përballet me sfida të shumta, si: degradimi i ekosistemeve pyjore, shfrytëzimi i paqëndrueshëm, erozioni, ne disa raste mbingarkesa e kullotave dhe rreziku i lartë nga zjarret.

Në zbatim të Ligjit nr. 57/2020 "Për pyjet", i cili përcakton rolin, funksionet dhe përgjegjësitë e njësive të vetëqeverisjes vendore për administrimin, mbrojtjen dhe zhvillimin e fondit pyjor dhe kullosor, Bashkia Has harton këtë plan strategjik si një dokument orientues për menaxhimin afatmesëm dhe të qëndrueshëm të burimeve natyrore të saj për periudhën 2026 - 2030.

Përdorimi i Territorit në Bashkinë Has

Bashkia Has shtrihet në një sipërfaqe totale prej **34,451.16 hektarësh**, e karakterizuar nga një përqendrim i lartë i fondit pyjor dhe kullosor. Struktura e përdorimit të territorit pasqyron potencialin natyror të zonës dhe nevojën për një menaxhim të kujdesshëm të burimeve natyrore.

Tabela 4 - Ndarja e tokës sipas kategorisë dhe sipërfaqes që mbulojnë

Kategoria e Tokës	Sipërfaqe (ha)	Përqindje (%)
Pyll	23,775.90	69.0%
Kullota dhe livadhe	5,508.50	16.0%
Tokë me bimësi	64.80	0.2%
Tokë inproduktive (e eroduar)	88.92	0.3%
Sipërfaqe të tjera (banim, rrugë, etj.)	4,828.43	14.0%
Sipërfaqe ujore	184.61	0.5%
Totali	**34,451.16**	**100%**

Ky shpërndarje dëshmon për rolin kyç që luajnë pyjet dhe kullotat në mjedisin, ekonominë dhe jetesën e komunitetit lokal, duke e bërë të domosdoshëm hartimin dhe zbatimin e një strategjie të qëndrueshme menaxhimi.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HAS




Figura 5 - Harta e mbulesës së Tokës.

Vizioni dhe Objektivat Strategjike

Vizioni

Të sigurohet ruajtja, përmirësimi dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i fondit pyjor dhe kullosor të Bashkisë Has, në funksion të gjeneratave të ardhshme, përmes një menaxhimi gjithëpërfshirës, të bazuar në parimet shkencore dhe në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, veçanërisht Ligjin nr. 57/2020 "Për pyjet në Republikën e Shqipërisë".

Objektivat Strategjikë

1. **Përmirësimi i cilësisë, strukturës dhe produktivitetit të fondit pyjor dhe kullosor**, për të garantuar funksionet ekologjike, ekonomike dhe sociale të tyre.
2. **Rritja e sipërfaqeve të pyllëzuara dhe ripyllëzimi i zonave të degraduara**, në funksion të rikuperimit të ekosistemeve natyrore dhe mbrojtjes së tokës nga erozioni.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS

3. **Forcimi i kapaciteteve institucionale dhe operacionale për mbrojtjen nga zjarret, përmbytjet dhe emergjencat natyrore**, duke përfshirë masa parandaluese dhe reagim të shpejtë.
4. **Zgjerimi dhe sigurimi i burimeve ujore**, si element mbështetës për biodiversitetin, pyllin, kullotat dhe zhvillimin e qëndrueshëm të blegtorisë.
5. **Rritja e ndërgjegjësimit publik dhe përfshirja aktive e komuniteteve lokale në proceset e planifikimit, mbrojtjes dhe menaxhimit të pyjeve dhe kullotave.**

Masat Prioritare Strategjike

Për realizimin e objektivave strategjike, Bashkia Has ka identifikuar një sërë masash prioritare që synojnë menaxhimin e qëndrueshëm dhe përmirësimin e fondit pyjor dhe kullosor, mbështetur në potencialet lokale dhe nevojat emergjente të territorit.

Masa 1: Ndërtimi i Lërave të Ujit në Zonat e Thata

- **Zona e Zbatimit**: Mujaj, Xhebexhi, Dajç, Gjinaj, Pus That, Pogaj.
- **Qëllimi**: Sigurimi i burimeve të qëndrueshme ujore për pyjet dhe kullotat në zonat me mungesë kronike uji.
- **Objektivi i Zbatimit**: Ndërtimi i 3 lërave të ujit gjatë një periudhe 5-vjeçare.
- **Rezultati i Pritshëm**: Përmirësim i qëndrueshmërisë ekologjike dhe rritje e kapacitetit kullosor në mbi **1,000 hektarë**.

Masa 2: Përmirësimi i Pyjeve përmes Ndërhyrjeve Silvikulturale

- **Qëllimi**: Rritja e cilësisë, shëndetit dhe qëndrueshmërisë së fondit pyjor nëpërmjet ndërhyrjeve të planifikuara dhe të kontrolluara.
- **Ndërhyrje Kryesore**:
  - Prerje selektive për ndriçim dhe stimulim të rigjenerimit;
  - Pastrim i nënpyllit dhe eliminim i masës djegëse;
  - Heqje e pemëve të dëmtuara dhe të sëmura.
- **Zbatim**: Në të gjitha njësitë administrative të Bashkisë Has.
- **Rezultati i Pritshëm**: Përmirësimi i gjendjes së pyjeve në një sipërfaqe rreth **100 hektarë**.

Masa 3: Përmirësimi i Kullotave

- **Qëllimi**: Rritja e kapacitetit ushqimor të kullotave dhe krijimi i kushteve më të mira për blegtorinë lokale.
- **Ndërhyrje**:
  - Heqje e gurëve dhe shkurreve të dëmshme;
  - Kontrolli i barërave të këqija konkurruese;

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HAS

- Përmirësim i aksesit dhe përdorshmërisë së kullotave.
- **Rezultati i Pritshëm**: Përmirësimi i sipërfaqes së kullotave në rreth **100 hektarë**.

Masa 4: Hapja e Korridoreve Mbrojtëse Kundër Zjarreve

- **Qëllimi**: Parandalimi dhe kontrolli i përhapjes së zjarreve në fondin pyjor dhe lehtësimi i ndërhyrjes në raste emergjente.
- **Ndërhyrje**:
  - Pastrim i bimësisë së dendur dhe materiale djegëse;
  - Hapje e korridoreve mbrojtëse dhe rrugëve dytësore për akses të shpejtë;

Masa 5: Pyllëzime dhe Ripyllëzime

- **Qëllimi**: Rikuperimi dhe rehabilitimi i tokave të degraduara si pasojë e erozionit, zjarreve ose shfrytëzimit të tepërt.
- **Synimi**: Realizimi i pyllëzimit dhe ripyllëzimit në një sipërfaqe minimale prej **20 hektarësh deri në vitin 2030**, me përdorimin e specieve vendase dhe teknika ekologjike të mbjelljes.

Masa 6: Ndërtimi i Pritave Malore për Mbrojtje nga Erozioni

- **Qëllimi**: Stabilizimi i terreneve të pjerrëta dhe parandalimi i humbjes së tokës produktive përmes strukturave mbrojtëse.
- **Zona e Synuar**: Përgjatë rrjedhave të ujërave sipërfaqësore dhe në zonat me erozion të theksuar.
- **Objektivi Teknik**: Ndërtimi i **1 km pritash malore**, të kombinuara me **gadhe çifte dhe teke**, në përputhje me karakteristikat gjeomorfologjike të terrenit.

Planifikimi i Zbatimit dhe Burimet e Financimit

Zbatimi i masave prioritare strategjike do të realizohet në një afat të përcaktuar kohor, me përgjegjësi të qarta institucionale dhe me mbështetje nga burime të ndryshme financimi. Koordinimi ndërmjet institucioneve vendore dhe partnerëve zhvillimorë do të jetë thelbësor për arritjen e objektivave të përcaktuara në këtë plan.

MASA	AFATI I ZBATIMIT	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	BURIME TË MUNDSHME FINANCIMI
NDËRTIMI I LËRAVE TË UJIT	2026 -2027	Bashkia Has/Drejtoria Sherbimit Pyjor	Buxheti i Bashkisë, Programet e qeverisë,donatorë ndërkombëtarë, organizata mjedisore, fonde të BE(etj)
PËRMIRËSIMI I PYJEVE	2026 - 2028	Bashkia Has/Drejtoria Sherbimit Pyjor	Buxheti i Bashkisë, Programet e qeverisë,donatorë ndërkombëtarë, organizata mjedisore, fonde të BE(etj)

PËRMIRËSIMI I KULLOTAVE	2026 - 2028	Bashkia Has/Drejtoria Sherbimit Pyjor	Buxheti i Bashkisë, Programet e qeverisë,donatorë ndërkombëtarë, organizata mjedisore, fonde të BE(etj)
HAPJA E KORRIDOREVE KUNDËR ZJARREVE	2026 - 2026	Bashkia Has/Drejtoria Sherbimit Pyjor	Buxheti i Bashkisë, Programet e qeverisë,donatorë ndërkombëtarë, organizata mjedisore, fonde të BE(etj)
PYLLËZIME DHE RIPYLLËZIME	2026 -2030	Bashkia Has/Drejtoria Sherbimit Pyjor	Buxheti i Bashkisë, Programet e qeverisë,donatorë ndërkombëtarë, organizata mjedisore, fonde të BE(etj)
NDËRTIMI I PRITAVE MALORE	2026 -2027	Bashkia Has/Drejtoria Sherbimit Pyjor	Buxheti i Bashkisë, Programet e qeverisë,donatorë ndërkombëtarë, organizata mjedisore, fonde të BE(etj)

Ndërtimi i Lërave të Ujit – Projekte të Planifikuara dhe Kostot e Parashikuara

Në kuadër të masave për përmirësimin e aksesit në burimet ujore për pyjet dhe kullotat, Bashkia Has ka planifikuar ndërtimin e **tre lërave të ujit** në zonat më të prekura nga thatësira, me kapacitete dhe kosto të përafërta. Përllogaritjet janë realizuar në përputhje me **VK.M. nr. 216, datë 13.04.2023**, Sistemi i integruar i manualit te çmimeve në ndertim, dhe bazuar në **librin e normave të punimeve në pyje**.

LËRA UJI	KAPACITETI (M^3)	VLERA E PARASHIKUAR (LEKË)	SHËNIME
LËRA NR. 1	308	3,095,103.6	Projekt me preventiv të detajuar
LËRA NR.-2	315	~3,100,000	Kapacitet pak më i madh
LËRA NR. 3	298	~3,000,000	Kapacitet pak më i vogël

Shuma e përgjithshme e parashikuar për tre lëra: rreth **9,195,000 lekë**

Projekti synon të përmirësojë ndjeshëm furnizimin me ujë në zonat **Mujaj, Xhebexhi, Dajç, Gjinaj, Pus That dhe Pogaj**, duke ndikuar pozitivisht në qëndrueshmërinë ekologjike të mbi **1,000 hektarëve pyje dhe kullota**.

Ndërhyrje Silvikulturale për Përmirësimin e Pyjeve - Përllogaritja e Kostove dhe Zonat e Zbatimit

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS

Në funksion të Masës 2 të Planit Strategjik - *"Përmirësimi i pyjeve përmes ndërhyrjeve silvikulturale"*, janë parashikuar ndërhyrje në sipërfaqe të përzgjedhura të fondit pyjor të Bashkisë Has, me synimin për të përmirësuar cilësinë e masivit pyjor dhe për të stimuluar rigjenerimin natyror të tij.

Kostot e ndërhyrjeve janë përllogaritur në përputhje me:

- **Librin e normave për punimet në fondin pyjor**, dhe
- **Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 158, datë 12.03.2022**, *"Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi"*, si bazë për llogaritjen e pagesës për orë pune të angazhuar në shërbimet pyjore.

Zonat dhe Përllogaritjet Financiare

Zona e Zbatimit	*Njësia Administrative*	*Sipërfaqja (ha)*	*Vlera e Parashikuar (lekë)*
Ekonomia Pyjore Krumë	Golaj	21.63	1,500,998.4
Pyje të shpërndara sipas planifikimit	Gjinaj, Krumë, Tregtan	78.37	Sipas përllogaritjeve në zbatim

Totali i sipërfaqes së parashikuar për ndërhyrje arrin në **100 hektarë**, të cilat do t'i nënshtrohen ndërhyrjeve të tipit:

- Prerje selektive dhe ndriçuese;
- Pastrim nënpylli dhe largim i masës djegëse;
- Heqje e pemëve të dëmtuara, të thara apo të sëmura.

Këto ndërhyrje do të realizohen me mbikëqyrje teknike, në përputhje me planet e menaxhimit të pyjeve dhe aktet përkatëse nënligjore.

Ndërhyrje për Përmirësimin e Kullotave - Përllogaritja e Kostove dhe Zonat e Zbatimit

Në funksion të **Masës 3 të Planit Strategjik - "Përmirësimi i kullotave"**, Bashkia Has ka planifikuar ndërhyrje konkrete në sipërfaqe të caktuara të kullotave publike, me qëllim rritjen e kapacitetit ushqimor, përmirësimin e biodiversitetit dhe funksionimit të qëndrueshëm të këtyre ekosistemeve.

Kostot e ndërhyrjeve janë përllogaritur në përputhje me:

- **Librin e normave të punimeve në pyje dhe kullota**, dhe
- **Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 158, datë 12.03.2022**, *"Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi"*, si bazë për llogaritjen e pagesës për orë pune të angazhuar në shërbimet teknike në terren.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HAS

Zonat dhe Përllogaritjet Financiare

Zona e Zbatimit	Njësia Administrative	Sipërfaqja (ha)	Vlera e Parashikuar (lekë)
Projekt konkret për kullota	Golaj	26.7	2,161,632
Kullota të shpërndara sipas planifikimit	Gjinaj, Golaj, Fajzë	73.3	Sipas përllogaritjeve në zbatim
Totali		**100.0**	**Rreth 7 milionë lekë të vjetra(vlerësim paraprak)**

Ky plan ndërhyrjesh synon të forcojë kapacitetin e përdorimit të kullotave, të mbështesë aktivitetet e blegtorisë dhe të ndihmojë në përmirësimin e qëndrueshmërisë së burimeve natyrore në Bashkinë Has.

Hapja e Korridoreve Mbrojtëse Kundër Zjarreve - Përllogaritja e Kostove dhe Zonat e Zbatimit

Në kuadër të **Masës 4 të Planit Strategjik - "Hapja e korridoreve mbrojtëse kundër zjarreve"**, Bashkia Has parashikon ndërhyrje të drejtpërdrejta për krijimin e korridoreve të pastruara me qëllim **parandalimin dhe frenimin e përhapjes së zjarreve në masivet pyjore**.

Këto ndërhyrje do të realizohen në përputhje me:

- **Librin e normave të punimeve në pyje dhe kullota**, si dokument bazë teknik për llogaritjen e volumit të punës dhe kostove;
- **Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 158, datë 12.03.2022**, *"Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi"*, si referencë për vlerësimin e kostos së orëve të punës në terren.

Zonat dhe Përllogaritjet Financiare

Zona e Zbatimit	Njësia Administrative	Gjatësia e korridorit (ml)	Gjerësia mesatare (m)	Sipërfaqja (ha)	Vlera e parashikuar (lekë)
Ekonomia Pyjore Krumë	Krumë	6,655	4	2.662	622,549
Zona të shpërndara të planifikuara	Gjinaj, Golaj, Helshan	—	—	10.0 (planifikuar)	Sipas përllogaritjeve
Totali				**12.662 ha**	**Rreth 1 milion lekë të vjetra(parashikim)**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA HAS

Korridoret do të shërbejnë si rrugë ndarëse dhe emergjente për ndërhyrje në raste zjarresh dhe do të kontribuojnë në menaxhimin aktiv të rreziqeve natyrore në fondin pyjor. Puna do të kryhet nga brigada të specializuara në bashkëpunim me strukturat pyjore dhe emergjencat civile.

Pyllëzime dhe Ripyllëzime - Përllogaritja e Kostove dhe Zonat e Zbatimit

Masa 5 e këtij Plani Strategjik parashikon **pyllëzimin dhe ripyllëzimin e sipërfaqeve të degraduara** në territorin e Bashkisë Has, me qëllim përmirësimin e cilësisë mjedisore, rritjen e kapacitetit thithës të karbonit dhe forcimin e rezistencës së tokave ndaj erozionit.

Ndërhyrjet do të realizohen në përputhje me:

- **Librin e normave të punimeve në pyje dhe kullota**, dhe
- **Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 158, datë 12.03.2022**, *"Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi"*, si bazë për përllogaritjen e kostove të punës së drejtpërdrejtë

Zonat dhe Përllogaritjet Financiare

Zona e Zbatimit	Njësia Administrative	Sipërfaqja (ha)	Vlera e Parashikuar (lekë)
Projekt i detajuar	Golaj	2.01	1,870,782.6
Zona të shpërndara të planifikuara	Krumë, Gjinaj, Tregtan	17.99	Sipas përllogaritjeve në zbatim
Totali		**20.00**	**Përafërsisht 18 - 20 milionë lekë të vjetra (parashikim total deri në vitin 2030)**

Pyllëzimet synohen të realizohen me **specie vendase të përshtatshme ekologjikisht**, në përputhje me praktikat më të mira të rigjenerimit pyjor dhe në koordinim me Agjencinë e Zhvillimit të Territorit dhe Drejtorinë Rajonale të Pyjeve.

Ndërtimi i Pritave Malore - Përllogaritja e Kostove dhe Zonat e Zbatimit

Masa 6 e Planit Strategjik synon ndërtimin e **pritave malore për mbrojtjen e terreneve të pjerrëta**, duke parandaluar erozionin dhe humbjen e tokës, si dhe duke ruajtur strukturën e peizazhit pyjor dhe kullosor.

Ndërhyrjet janë të përqendruara në ndërtimin e **pritave me gardh çift** sipas standardeve teknike të përcaktuara në:

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HAS

- **Librin e normave të punimeve në pyje dhe kullota**, dhe
- **Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 158, datë 12.03.2022**, *"Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi"*, për llogaritjen e kostove të punës.

Zonat dhe Përllogaritjet Financiare

Zona e Zbatimit	Njësia Administrative	Lloji i pritës	Gjatësia (ml)	Vlera e Parashikuar (lekë)
Projekt i detajuar	Krumë (ekonomia pyjore)	Gardh çift	120	349,056
Zona të shpërndara të planifikuara	Gjinaj, Krumë, Tregtan	Gardh çift	880	Sipas përllogaritjeve në zbatim
Totali			**1,000 ml**	**Përafërsisht 3 - 3.5 milionë lekë të vjetra (parashikim total)**

Pritat do të vendosen në zona me rrezik të lartë erozioni, bazuar në analizat e pjerrësisë, gjeomorfologjisë dhe degradimit të tokës. Ky investim synon të mbrojë tokat pyjore dhe kullosore nga rrëshqitjet dhe humbjet e sedimenteve, duke garantuar funksionimin ekologjik dhe ekonomik të zonave kodrinore.

Përmbledhje e Masave Strategjike për Zhvillimin e Pyjeve dhe Kullotave - Bashkia Has (2026 - 2030)

Masa	Përshkrimi	Zona e Zbatimit	Sipërfaqja / Gjatësia	Kosto e Parashikuar (lekë)	Burimi i Kostove
1	Ndërtimi i lërave të ujit	Mujaj, Xhebexhi, Dajç, Gjinaj, Pus That, Pogaj	3 njësi (kap. 308 - 315 m^3)	Rreth 9–9.5 milionë	Libri i normave + VKM nr. 216, datë 13.04.2023
2	Ndërhyrje Silvikulturale për përmirësimin e pyjeve	Golaj, Gjinaj, Krumë, Tregtan	100 ha (21.63 + 78.37 ha)	~1.5 milion + në zbatim	Libri i normave + VKM nr. 158, datë 12.03.2022
3	Përmirësimi i kullotave	Golaj, Gjinaj, Fajzë	100 ha (26.7 + 73.3 ha)	~2.16 milion + në zbatim	Libri i normave + VKM nr. 158, datë 12.03.2022
4	Korridore kundër zjarreve	Krumë, Gjinaj, Helshan, Golaj	12.66 ha (6655 ml + 10 ha plan)	~622,549 + në zbatim	Libri i normave + VKM nr. 158, datë 12.03.2022

5	Pyllëzime dhe ripyllëzime	Golaj, Gjinaj, Tregtan, Krumë	20 ha (2.01 ha projekt + 17.99)	~1.87 milion + në zbatim	Libri i normave + VKM nr. 158, datë 12.03.2022
6	Ndërtimi i pritave malore	Krumë, Gjinaj, Tregtan	1,000 ml (120 + 880 ml)	~349,056 + në zbatim	Libri i normave + VKM nr. 158, datë 12.03.2022

Vlerësimi Total Paraprak i Investimeve Strategjike (2026 - 2030)

≈ **18 - 22 milionë lekë të vjetra**, me mundësi financimi nga:

- **Bashkia Has** (nga të ardhurat vendore dhe taksa pyjore),
- **Donatorë ndërkombëtarë dhe projekte IPA/BE**,
- **Organizata të shoqërisë civile dhe mjedisit** (WWF, GIZ, CNVP, etj.),
- **Fondet e Ministrisë së Bujqësisë dhe Agjencisë së Pyjeve**.

Sektori Menaxhimit, Mbrojties së Tokës dhe Konsumatorit

Për të përcaktuar **prioritetet për 5 vitet e ardhshme në sektorin e menaxhimit, mbrojtjes së tokës dhe konsumatorit në Bashkinë Has**, është e rëndësishme të kemi parasysh karakteristikat lokale të zonës: terreni i thyer malor, sfidat infrastrukturore, zhvillimi rural, emigracioni, dhe ruajtja e pasurive natyrore dhe tokës bujqësore.

1. **Bazuar në ligjin 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore".**
2. **Ligji Nr.9244, datë 17.6.2004 "Për mbrojtjen e tokës bujqësore" (I ndryshuar).**
3. **Ligji Nr. 20/2020 Për përfundimin e proçeseve kalimtare të pronësisë në Republikes së Shqipërisë.**
4. **Ligji Nr. 7501 në vitin 1991, për token (I shfuqizuar)**

Më poshtë janë disa **prioritete strategjike** të sugjeruara për periudhën **2026-2030**:

1. Mbrojtja dhe menaxhimi i qëndrueshëm i tokës bujqësore.

- Inventarizimi dhe legalizimi i pronave të patundshme për të reduktuar konfliktet mbi tokën.
- Zbatimi i masave kundër erozionit dhe degradimit të tokës në zona të ndjeshme.
- Rritja e mbikëqyrjes për ndalimin e shfrytëzimit të paligjshëm të tokave bujqësore.
- Nxitja e përdorimit të praktikave të qëndrueshme bujqësore.

Objektiva

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HAS

- Të përfundohet hartimi dhe miratimi i një plani të menaxhimit të qëndrueshëm të tokës për të gjithë territorin e bashkisë.
- Të trajtohen e zonave me erozion të lartë përmes mbjelljeve ose ndërhyrjeve teknike.

2. Digjitalizimi i menaxhimit të tokës dhe pronësisë

- Krijimi i një sistemi digjital për regjistrimin dhe menaxhimin e të dhënave të tokës.
- Lehtësimi i qasjes së qytetarëve në informacion mbi pronat dhe shërbimet përkatëse.
- Integrimi me Kadastër, ASHK, DAMT,ZRPP dhe institucionet e tjera për shërbime më efikase.

Objektiva:

- Të krijohet një platformë digjitale për administrimin e të dhënave të pronës në bashki.
- Të skanohen dhe regjistrohen të gjitha dosjet fizike ekzistuese.
- Të reduktohet koha e trajtimit të kërkesave për dokumente pronësie.

3. Zhvillimi rural dhe përkrahja për fermerët/konsumatorët lokalë

- Skema subvencionesh për fermerët vendas për të përmirësuar prodhimin bujqësor dhe mbrojtjen e tokës.
- Nxitja e bashkëpunimit fermer–bashki për qasjen në tregje.
- Ndërtimi apo rikonstruktimi i rrugëve rurale për lehtësimin e qarkullimit të produkteve bujqësore.
- Edukimi dhe ndërgjegjësimi për sigurinë ushqimore dhe të drejtat e konsumatorëve.

Objektiva:

- Të mbështeten fermerët lokalë me **pajisje, trajnime apo subvencione** deri në vitin 2030.
- Deri në 2027, të rikonstruktohen të paktën 10 km rrugë rurale për akses më të lehtë në treg.
- Të organizohen çdo vit të paktën 2 **panaire lokale të produkteve vendore.**

4. Forcimi i inspektimit dhe zbatimit të ligjit

- Rritja e kapaciteteve për inspektim në terren lidhur me ndërtimet e paligjshme, ndotjen e tokës, prerjet e pyjeve etj.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HAS

- Vendosja e bashkëpunimit me strukturat e Policisë dhe të Mbrojtjes së Mjedisit për ndëshkimin e shkeljeve.
- Trajnime për punonjësit lokalë për të zbatuar legjislacionin për mbrojtjen e tokës dhe konsumatorit.

Objektiva:

- Të ngritët një **strukturë inspektimi funksionale** për tokën, ndërtimet dhe tregjet.
- Të realizohen inspektime për tregje, ndërtim të paligjshëm dhe shfrytëzim toke.
- Të përmirësohet besimi i qytetarëve në institucion.

5. Ndërgjegjësim dhe përfshirje e komunitetit

- Fushata sensibilizimi mbi rëndësinë e mbrojtjes së tokës, ujit dhe burimeve natyrore.
- Pjesëmarrje e komunitetit në vendimmarrje për plane të reja zhvillimore.
- Krijimi i grupeve lokale të monitorimit (shoqëri civile, fermerë, të rinj) për të ndihmuar në mbrojtjen e territorit.

Objektiva:

- Të krijohen **grupe komunitare monitorimi** në lagje/fshatra.
- Të organizohen fushata ndërgjegjësuese çdo vit mbi mbrojtjen e tokës dhe të drejtat e konsumatorit.
- Të përfshihen qytetarë në aktivitete konsultimi.

Tabela 5 - Treguesit agro-kimikë të profileve të tokës në Njësinë Administrative Fajzë.

Nr	Emërtimi i mostrës							
	Profili 1	**pH**	**K.E**	**Humusi**	**Fosfori**	**Kaliumi**	**$CaCO_3$**	
		ujor	**kripor**	**µS/cm**	**%**	**ppm**	**mg/100**	**%**
1	0-31	5.93	4.82	0.072	1.52	8.53	2.08	2.52
2	31-52	5.61	4.07	0.042	0.76	13.78	4.2	0.59
3	52-76	5.53	4.14	0.044	1.20	23.45	5.4	0.84
4	76-100	5.58	4.22	0.048	0.27	12.53	5.4	0.84
5	100-150	5.72	4.15	0.044	0.54	8.66	5.6	0.84
	Profili 2							
1	0-20	5.64	4.15	0.033	1.03	15.71	5.8	0.67
2	20-43	5.74	3.98	0.055	0.76	14.61	8.6	0.76

-REPUBLIKA E SHQIPËRISË- BASHKIA HAS

	Profili 3							
1	0-31	6.11	5.03	0.077	1.74	13.92	4.8	0.67
2	31-45	6.46	4.99	0.086	0.54	9.63	5.2	0.67
3	45-71	6.25	4.98	0.097	1.03	8.25	9.0	0.76
4	71-96	6.68	5.05	0.066	0.38	12.12	8.6	0.84
5	96-150	6.84	5.08	0.054	0.16	11.57	5.6	0.84
	Profili 4							
1	0-27	6.52	5.07	0.053	2.39	11.71	8.2	0.67
2	27-52	6.70	5.06	0.056	1.74	20.41	7.8	0.59
3	52-79	6.82	5.06	0.081	0.98	20.14	7.6	0.84
4	79-116	7.31	6.22	0.067	0.76	10.05	6.6	0.76
5	116-150	7.87	6.29	0.117	0.38	11.98	5.0	0.67
	Profili 5							
1	0-25	7.30	6.01	0.147	1.96	12.95	37.2	0.84
2	25-50	7.30	6.02	0.067	0.82	13.50	20.6	0.59
	Profili 6							
1	0-28	6.25	5.41	0.049	1.85	11.84	6.2	1.01
2	28-60	6.43	5.42	0.042	1.03	8.25	8.2	0.92

Nr	**Emërtim mostrës**	**Treguesit e analizuar** (bazat e kembyeshme)				**Përbërja mekanike** (granulometria)		
		Na	**K**	**Ca+**	**Mg+**	**Rërë**	**Lym**	**Argjil**
		mek/100 gr	mek/100gr			%	%	%
	Profili 1							
1	0-31	0.080	0.044	7.31	3.58	50.4	21.6	28.0
2	31-52	0.071	0.089	6.20	3.70	52.0	21.6	26.4
3	52-76	0.064	0.114	7.18	4.52	46.4	20.8	28.8
4	76-100	0.060	0.114	6.94	4.72	47.6	16.8	35.6
5	100-150	0.060	0.118	7.37	4.96	44.8	15.2	40.0
	Profili 2							
1	0-20	0.064	0.122	7.06	3.90	52.0	22.8	25.2
2	20-43	0.065	0.182	13.14	6.36	55.2	15.6	29.2
3	**Profili 3**							
4	0-31	0.122	0.101	7.73	4.96	45.6	26.4	28.0
5	31-45	0.100	0.110	7.12	7.43	34.0	28.8	37.2
	45-71	0.199	0.190	13.05	14.96	27.6	20.4	52.0
1	71-96	0.190	0.181	12.81	17.02	29.6	16.0	54.4

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS

2	96-150	0.090	0.118	11.83	14.96	45.2	22.0	32.8
	Profili 4							
1	0-27	0.102	0.173	17.73	16.28	22.8	27.6	49.6
2	27-52	0.106	0.164	16.22	24.28	25.6	30.0	44.4
3	52-79	0.101	0.160	15.87	26.88	26.0	18.0	56.0
4	79-116	0.201	0.139	27.28	37.32	10.6	9.4	80.0
5	116-150	0.078	0.105	32.68	41.92	16.8	40.6	42.6
	Profili 5							
1	0-25	0.057	0.784	27.38	5.84	18.8	35.6	45.6
2	25-50	0.202	0.434	26.61	11.29	32.4	18.4	49.2
	Profili 6							
1	0-28	0.040	0.131	19.44	7.23	55.2	15.6	29.2
2	28-60	0.039	0.173	13.59	18.66	37.6	19.6	42.8

*Analiza të bëra nga **Qendra e Transferimit te Teknologjive Bujqesore.**

Shërbimet Publike, Bordi Kullimit, Rrugët

Hyrje

Ky plan synon të përcaktoje prioritetet dhe drejtimet kryesore të zhvillimit për shërbimet publike, menaxhimin e infrastrukturës rrugore dhe sistemet e ujitjes/kullimit në territorin e Bashkisë Has, duke rritur cilësinë e jetës së qytetarëve dhe duke siguruar një zhvillim të qëndrueshëm.

Analiza e situates aktuale

- Shërbimet publike: nevoja për pastrim më efikas, gjelbërim urban, menaxhim më të mirë të mbetjeve.

- Rrugët: infrastrukturë e amortizuar në disa zona rurale, mungesë mirëmbajtjeje të rregullt.

- Kullimi dhe ujitja: kanalet ekzistuese shpesh të bllokuara, mungesë investimesh moderne.

- Resurset: buxhet i kufizuar vendor, por mundësi financimi nga programe kombëtare dhe fonde të BE.

Qëllimi "Të krijohet një infrastrukturë moderne rrugore dhe një sistem funksional i shërbimeve dhe kullimit, që garanton standarde të larta jetese, zhvillim ekonomik e bujqësor për qytetarët e Bashkisë Has."

Objektivat Strategjikë Shërbimet Publike:

1. Rritja e fuqisë punëtore.
2. Kontinier mbetjesh.
3. Rritja e efikasitetit në pastrimin e qytetit dhe zonave rurale.
4. Zhvillimi i hapësirave të gjelbra dhe dekorative.
5. Përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve (selektimi, riciklimi).



6. Makineri për transport mbetjesh, kamionçin për transportin e mbetjeve brenda në qytet.
7. Kositëse bari të modernizuara.
8. Bot uji (spërkatja e territorit të qytetit)

Rrugët

1. Mirëmbajtje e rregullt e rrugëve ekzistuese.
2. Rehabilitimi i rrugëve kryesore që lidhin fshatrat me qendrën.
3. Ndërtimi i segmenteve të reja për të përmirësuar lidhjet ekonomike dhe turistike.
4. Mjete për rikonstruksion të rrugëve me kalldram (fadrom, kamion).

Bordi i Kullimit

1.Pastrimi dhe rikonstruksioni i kanaleve kulluese.
2. Modernizimi i sistemit të ujitjes për bujqësinë.
3. Zhvillimi i projekteve për parandalimin e përmbytjeve.
4. Restaurim digash.
5. Makineri transporti për punonjësit e shërbimit.
6. Makineri varinks 5 tonesh (për pastrimin e kanaleve).

Artikulli	Sasia	Vlera parashikuar (Lekë)
Kosh 240L me rrota, industrial	50	355,000
Kosh metalik për ambient të jashtëm 40cm	30	180,000
Kamionçinë për transportin e mbetjeve	2	5,000,000
Kositëse bari të modernizuara	3	360,000
Bot uji	1	800,000
Fadrom	1	5,500,000
Kamion	1	7,500,000
Makineri varinks 5 tonësh	1	1,800,000
		Totali = 21,495,000

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HAS

Emergjencat Civile

Qëllimi

Ky plan strategjik është një dokument udhëzues afatmesëm (2026 -2030) për sektorin e emergjencave civile në Bashkinë Has, i cili synon të:

- Forcojë kapacitetet vendore për përballimin e fatkeqësive natyrore dhe teknologjike;
- Përcaktojë prioritetet për parandalimin, reagimin dhe rimëkëmbjen nga ngjarjet e jashtëzakonshme;
- Sigurojë një qasje të koordinuar ndërinstitucionale për menaxhimin e rreziqeve;
- Përfshijë komunitetin në proceset e vetëmbrojtjes dhe edukimit për emergjencat.

Ky dokument fokusohet në rreziqet më të zakonshme që prekin territorin e Bashkisë Has, përfshirë reshjet e shiut, dëborës, rrëshqitjet e dherave, tërmetet, fenomenet biologjike dhe incidentet teknologjike.

Plani është hartuar duke ndjekur një qasje gjithëpërfshirëse që përfshin:

- Analizë të të dhënave historike mbi emergjencat e ndodhura në territor;
- Vlerësim të kapaciteteve dhe mangësive ekzistuese;
- Konsultime me strukturat vendore, institucionet kombëtare, komunitetin dhe partnerët zhvillimorë;
- Përdorim të standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare të menaxhimit të emergjencave, Ligji Nr. 45/2019 "Për Mbrojtjen Civile".

Analiza

Faktorët Natyrorë të Rrezikut

Bashkia Has, për shkak të karakteristikave të saj gjeografike dhe klimaterike, është e ekspozuar ndaj një game të gjerë rreziqesh natyrore:

- **Reshjet e shiut:** shkaktojnë përmbytje të përkohshme dhe rritje të rrezikut për rrëshqitje të dherave.
- **Reshjet e dëborës:** pengojnë lëvizjen, izolojnë zonat rurale, ndikojnë në furnizimin me energji elektrike dhe ushqime.
- **Erat e forta:** dëmtojnë infrastrukturën (çati, rrjete elektrike, pemë).

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HAS

- **Rrëshqitjet e tokës:** problematikë serioze për banesat dhe infrastrukturën rrugore në zonat me terren të pjerrët.
- **Tërmetet:** ndonëse jo shumë të shpeshta, zona ndodhet në një brez me aktivitet sizmik të moderuar.
- **Rreziqet biologjike:** përfshirë shpërthime të sëmundjeve infektive tek njerëzit dhe blegtorinë (p.sh., COVID-19, etj.).
- **Rreziqet teknologjike:** përfshijnë aksidente rrugore, rrjedhje të gazit, defekte në linjat e tensionit dhe rreziqe nga përdorimi i karburanteve në mënyrë të pasigurt.

Rreziqet Biologjike dhe Teknologjike

Rreziqet Biologjike:

- Përhapja e **sëmundjeve infektive**, si gripi i shpendëve, bruceloza, tuberkulozi dhe raste të shpërthyera të COVID-19, mbeten shqetësime për shëndetin publik dhe atë veterinar.
- Mungesa e aksesit në shërbime shëndetësore cilësore për fshatrat e thella e vështirëson reagimin në kohë.

Rreziqet Teknologjike:

- **Aksidentet rrugore** në rrugët malore dhe me sinjalistikë të kufizuar.
- **Defektet në rrjetin elektrik**, veçanërisht gjatë stuhive dhe reshjeve të mëdha.
- **Përdorimi i pasigurt i bombolave të gazit** dhe karburanteve në shtëpi, rrit rrezikun e shpërthimeve apo zjarreve.

Vizioni Strategjik 2026 - 2030

Një Bashki rezistente ndaj katastrofave, me një sistem të integruar emergjence që mbron jetën, pronën dhe mjedisin përmes ndërhyrjes së shpejtë, parandalimit dhe rimëkëmbjes së qëndrueshme.

Objektivat Kryesore

1. Forcimi i kapaciteteve institucionale të emergjencave civile në nivel bashkiak.
2. Përmirësimi i sistemeve të parashikimit dhe paralajmërimit të hershëm për rreziqet natyrore.
3. Reduktimi i rrezikut nga katastrofat përmes planifikimit urban dhe ndërhyrjeve infrastrukturore.
4. Rritja e ndërgjegjësimit të komunitetit për përgjigjen ndaj emergjencave.
5. Zhvillimi i një plani të integruar të rimëkëmbjes dhe rikonstruksionit pas fatkeqësive.

BASHKIA HAS

PARANDALIMI, PËRGATITKJA DHE REAGIMI

Parandalimi është elementi kyç për të minimizuar ndikimin e emergjencave civile dhe për të mbrojtur jetën dhe pronën e qytetarëve.

Masa kryesore përfshijnë:

- **Përmirësimi i infrastrukturës së mbrojtjes civile:** Riparimi dhe zgjerimi i sistemit të kullimit për përmbytjet, ndërtimi i barrierave mbrojtëse në zonat me rrëshqitje të mundshme dhe përforcimi i strukturave që mund të dëmtohen nga erërat e forta dhe tërmetet.
- **Zbatimi i rregullave të ndërtimit dhe planifikimit territorial:** Monitorimi rigoroz i ndërtimeve sipas standardeve anti-sizmike dhe përmirësimi i planifikimit urban për shmangien e ndërtimit në zona me risk të lartë.
- **Monitorimi i vazhdueshëm i faktorëve të rrezikut:** Vendosja e sensorëve meteorologjikë dhe sistemit të paralajmërimit të hershëm për reshje të shumta, erëra të forta dhe fenomene të tjera ekstreme.
- **Fushata ndërgjegjësuese për komunitetin:** Edukimi i qytetarëve mbi masat parandaluese dhe veprimet që duhen ndërmarrë para dhe gjatë emergjencave për mbrojtjen e tyre.

Strukturat Vendimmarrëse në Rast Emergjencash

Për të siguruar një reagim të shpejtë dhe të koordinuar, janë ngritur strukturat vendimmarrëse me përgjegjësi të qarta:

- **Komiteti Lokal për Emergjencat Civile:** Një organ udhëheqës që përbëhet nga përfaqësues të Bashkisë, Policisë, Shërbimeve Shëndetësore, Zjarrfikësve dhe institucioneve të tjera relevante. Komiteti mban përgjegjësi për koordinimin strategjik dhe marrjen e vendimeve kryesore.
- **Qendra e Koordinimit të Emergjencave:** Një strukturë operative që monitoron situatën në kohë reale, koordinon përgjigjen në terren dhe menaxhon burimet në dispozicion.
- **Ekipet Lokale të Emergjencave:** Grupet e specializuara që intervenojnë në terren për vlerësimin e situatës, ndërhyrje urgjente dhe asistencë banorëve të prekur.

Koordinimi Ndërinstitucional

Një menaxhim efektiv i emergjencave kërkon bashkëpunim të ngushtë midis të gjitha aktorëve, në nivel lokal dhe rajonal:

- **Sistemi i Komunikimit të Integruar:** Përdorimi i platformave të përbashkëta digjitale dhe pajisjeve moderne për shkëmbimin e informacionit në kohë reale mes institucioneve.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË- BASHKIA HAS

- **Marrëveshje Bashkëpunimi:** Formalizimi i marrëveshjeve midis Bashkisë Has dhe institucioneve si Policia, Shërbimi Shëndetësor, Organizatat Joqeveritare dhe strukturat rajonale të emergjencave për përgjigje të përbashkët.
- **Planifikimi i Përbashkët:** Organizimi i takimeve periodike dhe ushtrimeve simulate për përmirësimin e koordinimit dhe ndërveprimit ndërinstitucional.
- **Përfshirja e Komunitetit:** Bashkëpunimi me përfaqësues të komuniteteve lokale për informim, paralajmërim dhe angazhim aktiv në masat parandaluese dhe reagimin emergjent.

Rimëkëmbja mbas katastrofave

Rimëkëmbja mbas katastrofave është një fazë kyçe në ciklin e emergjencave dhe synon rikthimin në normalitet të komunitetit, përmes ndërhyrjes së koordinuar në infrastrukturë, shërbime, ekonomi dhe mirëqenie psikologjike e sociale. Bashkia Has, si njësia bazë e qeverisjes vendore, ka për detyrë të udhëheqë këtë proces përmes mekanizmave të qartë dhe të qëndrueshëm.

Mekanizmat e Vlerësimit të Dëmeve

Qëllimi: Të sigurohet një proces transparent, i shpejtë dhe i besueshëm për evidentimin e dëmeve pas çdo fatkeqësie.

Mekanizmat që do të përdoren:

- **Grupet e emergjencës lokale**: Aktivizimi i grupeve të vlerësimit në nivel lagjeje/fshati me pjesëmarrje të inxhinierëve, teknikëve, përfaqësuesve të komunitetit.
- **Formularë standard të vlerësimit të dëmit**: Të miratuar nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile.
- **Regjistër digjital i dëmeve**: Regjistrim në kohë reale për shtëpitë, bujqësinë, infrastrukturën dhe bizneset e prekura.
- **Përdorimi i dronëve dhe fotografisë ajrore** (në bashkëpunim me partnerë): Për të dokumentuar zonat më të dëmtuara.
- **Afati për përfundimin e vlerësimeve të para**: Brenda 72 orëve nga përfundimi i ngjarjes.

Politikat e Rindërtimit të Qëndrueshëm

Qëllimi: Jo vetëm të rikthehet gjendja e mëparshme, por të ndërtohet më mirë dhe më qëndrueshëm për të ardhmen.

Parimet kryesore:

- **"Ndërto më mirë":** Objektet që rindërtohen të respektojnë standardet sizmike, klimaterike dhe ekologjike.
- **Përparësi për objektet kritike**: Shkolla, qendra shëndetësore, rrugë strategjike dhe ujësjellës.
- **Përdorimi i materialeve dhe teknikave të qëndrueshme**: Për të përballuar fatkeqësitë e ardhshme.
- **Planifikim urban dhe rural i përmirësuar**: Moslejimi i rindërtimit në zona të rrezikuara nga përmbytjet, rrëshqitjet, etj.
- **Bashkëfinancim dhe partneritet**: Me qeverinë qendrore, donatorët ndërkombëtarë dhe komunitetin lokal.

Ndihma Sociale dhe Psikologjike

Qëllimi: Të zbutet ndikimi emocional dhe ekonomik i katastrofës mbi qytetarët, veçanërisht grupet në nevojë.

Masa të planifikuara:

- **Ekip lëvizës i mbështetjes psikologjike**: Në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Shëndetit dhe OJF-të.
- **Mbështetje për gratë, të moshuarit dhe fëmijët**: Prioritet në shpërndarjen e ndihmave dhe strehimin e përkohshëm.
- **Kthimi i shpejtë në shkollë për fëmijët e prekur**: Nëse shkollat dëmtohen, të krijohen klasa të përkohshme.
- **Ndihmë financiare e menjëhershme** për familjet që kanë humbur shtëpinë ose të ardhurat (nëpërmjet Fondit të Emergjencave).
- **Strehim i përkohshëm në ambiente të përshtatshme**: Konvikt, Hotele, Shkolla etj.

Prioritetet

Investimet Prioritare

Përballja me emergjencat civile kërkon infrastrukturë të fuqishme dhe pajisje moderne. Bashkia Has do të fokusohet në investime të drejtuara që rrisin aftësinë e reagimit dhe rimëkëmbjes.

- **Blerja e pajisjeve emergjente**: Për shembull, motopompat do të lehtësojnë largimin e ujit gjatë përmbytjeve, gjeneratorët do të sigurojnë energji emergjente për qendrat e emergjencave dhe strehimorët, ndërsa automjetet 4x4 do të mundësojnë qasje në terrene të vështira malore gjatë reshjeve të borës apo rrëshqitjeve. Këto pajisje janë thelbësore për një reagim të shpejtë dhe efektiv.

BASHKIA HAS

- **Formimi i rezervave emergjente**: Përgatitja e stokut bazë për të paktën 500 familje në zona të rrezikuara siguron mbështetje të menjëhershme për popullsinë në rast izolimi apo fatkeqësish natyrore, duke shmangur krizën humanitare.
- **Fond emergjence për reagim të shpejtë**: Ky fond financiar do të përdoret për shpenzime të papritura dhe urgjente si karburanti për automjetet emergjente, blerja e materialeve të nevojshme apo shërbime të jashtëzakonshme, duke përshpejtuar ndërhyrjen dhe zvogëluar burokracitë administrative.
- **Përmirësimi i rrjetit të komunikimit**: Pajisjet radio dhe sistemet digjitale do të modernizohen për të siguruar komunikim të pandërprerë midis ekipeve të emergjencave në zonat rurale dhe malore, ku rrjetet tradicionale shpesh janë të dobëta.

Trajnimet dhe Ndërgjegjësimi Publik

Një nga shtyllat kryesore për menaxhimin efektiv të emergjencave është përgatitja e njerëzve, qofshin ata profesionistë apo qytetarë.

- **Trajnimet periodike për stafin**: Personeli i emergjencave civile do të marrë trajnime të specializuara për ndërhyrje në situata të ndryshme (përmbytje, zjarre, tërmete), duke përfshirë përdorimin e pajisjeve të reja dhe procedurat më të mira të operimit.
- **Fushata ndërgjegjësuese për komunitetin**: Edukimi i qytetarëve mbi mënyrat e vetëmbrojtjes, ndihmës së parë, dhe masave preventive do të ulin rrezikun dhe do të rrisë pjesëmarrjen e tyre aktive në situata krizash.
- **Simulimet dhe ushtrimet praktike**: Duke organizuar stërvitje të përbashkëta në shkolla, komunitete rurale dhe qytete, Bashkia do të testojë gatishmërinë operacionale dhe do të identifikojë mangësitë për përmirësim të mëtejshëm.
- **Bashkëpunimi me media lokale**: Për të përhapur mesazhe preventive dhe njoftime të shpejta në situata emergjente, duke arritur më shumë qytetarë në kohë reale.

Teknologjia dhe Digjitalizimi

Teknologjia luan një rol vendimtar në menaxhimin modern të emergjencave, përmes përmirësimit të kapaciteteve monitoruese dhe koordinuese.

- **Platforma digjitale për njoftime emergjente**: Një aplikacion dhe faqe interneti dedikuar do të mundësojë që qytetarët të marrin paralajmërime të hershme, udhëzime dhe informacione në kohë reale mbi fatkeqësitë dhe masat që duhet të ndërmarrin.
- **Sisteme monitorimi të motit dhe lrezervuarëve/përrenjëve**: Me sensorë dhe bashkëpunim me Institutin Meteorologjik, do të ndihmojë në parashikimin e përmbytjeve apo erërave të forta, duke mundësuar ndërhyrje preventive.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS

Përdorimi i dronëve: **Këto pajisje do të përdoren për vlerësimin e shpejtë të dëmeve në zona të pakalueshme, duke dhënë informacion të detajuar për planifikimin e ndërhyrjeve dhe shpëtimit.**

Prioritete Kryesore

- Financim për mjete logjistike (4x4, borëpastruese, pompa uji, etj.).
- Trajnime për personelin lokal.
- Forcimi i bashkëpunimit me strukturat e emergjencave rajonale dhe kombëtare.

Nr.	Nevoja Prioritare	Sasia/Specifikimi	Vlera e parashikuar në (lekë)
1	Pajisje për ndërhyrje në raste përmbytjesh dhe zjarresh	3 motopompa uji, 2 gjeneratorë portativë	35,000
2	Mjet borëpastrues për zonat malore	1 automjet i specializuar	85,000
3	Automjet 4x4 për operacione emergjente në terren të vështirë	2 automjete (tip Toyota Hilux ose të ngjashëm)	70,000
4	Radio-komunikim emergjence për fshatra të izoluara	20 njësi komunikimi (radio UHF)	12,000
5	Pajisje personale për stafin e emergjencave (uniforma, helmeta, veshje antishtypje, fenerë, çanta mjekësore)	10 komplete të plota	8,000
6	Rezerva ushqimore, ujë dhe materiale bazë për 500 familje në raste emergjente	3 muaj stoku (ushqim, ujë, batanije, ilaçe)	40,000
7	Trajnime dhe simulime për stafin dhe komunitetin	10 trajnime në vit për 5 vite (në terren)	25,000
8	Fond emergjence i dedikuar për reagim të shpejtë (p.sh., karburant, transport, ndihmë urgjente)	Rezervë e parashikuar për vit	50,000/vit × 5 = 250,000

Drejtoria e Arsimit, Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Vizioni 2026 - 2030

"Bashkia Has synon të garantojë një sistem arsimor modern dhe gjithëpërfshirës, një jetë kulturore të gjallë dhe të trashëguar, një rini aktive dhe të integruar në zhvillimin lokal, si dhe sport të qasshëm për të gjithë qytetarët, duke ndërtuar kështu themelet për zhvillim social dhe ekonomik të qëndrueshëm."

Prioritetet Strategjike dhe Objektivat

1. Arsimi

Qëllimi: Rritja e cilësisë së arsimit dhe sigurimi i kushteve të barabarta për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë në territorin e Bashkisë Has.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË- BASHKIA HAS

- **Objektivi 1: Përmirësimi i infrastrukturës arsimore.**

  1. Rikonstruksioni i shkollave ekzistuese në qytet dhe fshatra.
  2. Ndërtimi i shkollave të reja fillore në zonat me popullsi të shpërndarë.
  3. Pajisja e shkollave me kabinete laboratorike dhe teknologji moderne.

- **Objektivi 2: Cilësia e mësimdhënies.**

  1. Trajnime për mësuesit në metoda bashkëkohore.
  2. Futja e mësimit digjital dhe përdorimi i platformave online.
  3. Mbështetje për aktivitete jashtëshkollore (klube letrare, teknologjike, artistike).

- **Objektivi 3: Ulja e braktisjes shkollore.**

  1. Program mbështetës për nxënësit në nevojë (transport, tekste, bursa).
  2. Partneritete me OJF dhe donatorë për arsimin gjithëpërfshirës.

2. Kultura

Qëllimi: Ruajtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore dhe nxitja e aktiviteteve artistike e kulturore moderne.

- **Objektivi 1: Trashëgimia kulturore.**

  1. Rindërtimi i Muzeut Etnografik "Ish Internati".
  2. Restaurimi i kullave dhe monumenteve historike në zonat kryesore.

- **Objektivi 2: Organizimi i aktiviteteve kulturore.**

  1. Festival vjetor për muzikë, vallëzim dhe kulinari.
  2. Ekspozita fotografike e artizanale.
  3. Mbështetje për ansamblet dhe grupet artistike lokale me kostume tradicionale.

- **Objektivi 3: Infrastruktura kulturore.**
  - Ndërtimi i një Qendre Kulturore Multifunksionale në Krumë (teatër, sallë ekspozitash, kinema).

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS

3. Rinia

Qëllimi: Të rinjtë të bëhen aktorë kryesorë në zhvillimin lokal përmes edukimit, pjesëmarrjes dhe sipërmarrjes.

- **Objektivi 1: Hapësira për të rinjtë.**
    1. Krijimi i një Qendre Rinore me ambiente për kurse, inovacion dhe aktivitete sociale.
    2. Bibliotekë moderne.
- **Objektivi 2: Pjesëmarrja në vendimmarrje.**
    1. Forume rinore vjetore për konsultim mbi politikat vendore.
- **Objektivi 3: Punësim dhe sipërmarrje rinore.**
    1. Trajnime për aftësi digjitale, gjuhë të huaja dhe bujqësi moderne.
    2. Skema mbështetëse për start-up rinore (IT, artizanat, agroturizëm).

4. Sporti

Qëllimi: Zhvillimi i sportit si mjet edukimi, argëtimi dhe përmirësimi i shëndetit të qytetarëve.

- **Objektivi 1: Infrastruktura sportive.**
    1. Rikonstruksioni i fushave sportive ekzistuese në shkolla.
    2. Ndërtimi i një Komleksi Sportiv Multifunksional në Krumë.
- **Objektivi 2: Sport masiv dhe tradicional.**
    1. Organizimi i aktiviteteve sportive ndër-shkollore.
    2. Promovimi i sporteve tradicionale (mundje, atletikë popullore).
- **Objektivi 3: Mbështetje për ekipet sportive.**
    1. Financim i ekipeve lokale të futbollit, volejbollit dhe sporteve individuale.
    2. Sigurim pajisjesh sportive.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS

Projekti	Vlera parashikuar në(lekë)
Blerje e kostumeve tradicionale (rroba kombëtare) dhe veglave muzikore	5,749,000
Rindërtimi i muzeut etnografik lokal 'Ish Internati'	65,000,000
Ndërtimi i fushës sportive Krumë	38,298,359
	Totali = 109,047,359

Qendra Kulturore e Fëmijëve

Vizioni

"Të zhvillojmë aftësitë artistike, kulturore dhe krijuese të fëmijëve të Hasit, duke ofruar hapësira edukative, kulturore dhe rekreative që forcojnë identitetin lokal dhe promovojnë talentet e reja."

Misioni

Të ofrojë mundësi gjithëpërfshirëse për fëmijët për zhvillim personal, art dhe kulturë, duke nxitur kreativitetin, bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen në aktivitete komunitare.

Analiza e Situates

Qendra Kulturore e Femijeve aktualisht disponon

1. Dy klasa pune per muzik dhe teatër.
2. Nje boks për muzikë.

Aktualisht jane 80 nxënës ;valltarë,instrumentist,aktrim.

Prioritetet Strategjike dhe Objektivat

1. Zhvillimi i Aftësive Kulturore dhe Artistike

- Organizimi i kurseve për art, muzikë, vallëzim, teatër dhe punime krijuese.
- Mbështetje për krijimin e grupeve artistike fëmijësh dhe ansambleve lokale.
- Trajnime për mësuesit dhe instruktorë fëmijësh.

2. Infrastruktura dhe Pajisjet

- Përmirësimi i hapësirave të qendrës për aktivitete artistike dhe edukative.
- Pajisje muzikore, materiale arti, pajisje teknologjike dhe kompjuterë.
- Ambient për ekspozita dhe shfaqje të fëmijëve.

3. Pjesëmarrja e Fëmijëve në Aktivitetet Kulturore

REPUBLIKA E SHQIPËRISË- BASHKIA HAS

- Program vjetor i aktiviteteve kreative dhe festivalit të talentëve.
- Konkurrime, ekspozita dhe shfaqje teatrale.
- Bashkëpunim me shkolla për integrimin e aktiviteteve kulturore.

4. Promovimi i Talentit dhe Integrimi në Komunitet

- Organizimi i aktiviteteve publike për familjet dhe komunitetin.
- Partneritete me qendra kulturore dhe organizata rinore në Shqipëri.
- Krijimi i platformës online për promovimin e talentit të fëmijëve.

5. Edukimi në Vlera dhe Trashëgimi Kulturore

- Program edukativ për njohjen e historisë dhe kulturës së Hasit.
- Integrimi i elementeve të trashëgimisë në kurset e artit dhe aktiviteteve kulturore.

Nr	Emërtimi	Sasia	çmimi për njësi/ lekë	Vlera parashikuar në lekë
1	Çifteli	30	20000	6,00,000
2	Defa	10	5000	50,000
3	Fyll	10	1000	10,000
4	Daulle (loder)	2	50000	1,00,000
5	Tarabuk	2	20000	40,000
6	Curle	2	40000	80,000
7	Boks aktiv	1	50000	50,000
8	Mikrofona	3	20000	60,000
9	Pjano	1	50000	50,000
	TOTALI			1,040,000
1	Veshje hasi per vajza mosha 6-10 vjec	10	50000	5,00,000
2	Veshje hasi per vajza mosha 10-15 vjec	10	70000	7,00,000

3	Veshje kombetare per djem mosha 6-10	10	6000	60,000
4	Veshje kombetare per djem mosha 10-15	10	8000	80,000
	Totali			1,520,000

Sektori Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit

Hyrje

Plani Strategjik 2026 - 2030 i Zyrës së Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit të Bashkisë Has përfaqëson një dokument orientues dhe gjithëpërfshirës, i cili synon të udhëheqë zhvillimin lokal në mënyrë të qëndrueshme dhe të koordinuar gjatë pesë viteve të ardhshme. Duke u mbështetur në potencialet natyrore, resurset njerëzore, trashëgiminë kulturore dhe pozicionin gjeografik të veçantë të Bashkisë Has, ky plan vendos objektiva të qarta për nxitjen e investimeve lokale, përmirësimin e infrastrukturës, zhvillimin e turizmit dhe fuqizimin e komunitetit përmes mundësive të reja ekonomike.

Ky dokument është hartuar në përputhje me politikat kombëtare të zhvillimit rajonal dhe integrimin evropian, dhe reflekton nevojën për bashkëpunim ndërinstitucional, angazhim të komunitetit dhe përdorim efikas të burimeve publike dhe private. Vizioni i planit synon të kthejë Bashkinë Has në një model të zhvillimit të qëndrueshëm rural, ku ekonomia lokale lulëzon dhe turizmi luan një rol kyç në përmirësimin e cilësisë së jetës për banorët.

Analiza e Situatës Aktualë

Deri më tani, Bashkia Hasit përballet me një sërë sfidash strukturore që ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin ekonomik,turistik dhe social të territorit. Ekonomia lokale është e përqendruar në aktivitete të vogla bujqësore dhe blegtorale dhe shumë pak drejt turizmit me nivel të ulët diversifikimi dhe me zinxhirë të fragmentuar prodhimi. Përpunimi i produkteve është minimal, ndërsa qasja në tregje mbetet e kufizuar për shkak të mungesës së infrastrukturës mbështetëse dhe kapaciteteve logjistike.

Turizmi mbetet një sektor me potencial të pazhvilluar, ku mungesa e strukturave pritëse, sinjalistikës dhe paketave të integruara e pengojnë territorin të shndërrohet në destinacion të qëndrueshëm. Pavarësisht burimeve natyrore dhe pasurive kulturore, mungon një strategji funksionale për zhvillimin e këtij sektori.

Nga pikëpamja sociale, ndihen efektet e thella të emigrimit, sidomos të të rinjve dhe familjeve të reja, çka ka sjellë plakjen e popullsisë dhe tkurrjen e kërkesës për shërbime vendore. Shërbimet

-REPUBLIKA E SHQIPËRISË- BASHKIA HAS

publike janë të kufizuara, veçanërisht në zonat periferike, ndërsa përfshirja e grave dhe të rinjve në zhvillimin ekonomik mbetet e ulët. Pavarësisht sfidave, në komunitet ekziston një potencial për aktivizim dhe vetorganizim, i cili mund të kanalizohet drejt zhvillimit përmes ndërhyrjeve të planifikuara dhe mbështetjes institucionale.

Gjendja ekonomike aktuale

Ekonomia e Bashkisë Has mbetet e karakterizuar nga një strukturë e fragmentuar dhe një varësi e lartë nga sektorët tradicionalë si bujqësia, blegtoria dhe shfrytëzimi i burimeve natyrore.Aktivitetet ekonomike zhvillohen kryesisht në mënyrë individuale apo familjare, me pak raste të organizimit në forma kolektive apo ndërmarrje të vogla të formalizuara. Tregu lokal është i kufizuar dhe i varur në masë të madhe nga ekonomitë e vetëprodhimit dhe shkëmbimeve joformale.

Përpunimi i produkteve bujqësore dhe blegtorale është minimal, me mungesë të pajisjeve moderne, teknologjisë së re dhe zinxhirëve të integruar të vlerës. Pavarësisht kësaj, Bashkia Has ofron disa produkte të veçanta vendore me potencial për tregje më të gjera, si mjalti, bimët mjekësore, qumështi nënproduktet e tij dhe produkte të tjera natyrale të cilat ende nuk janë të standardizuara apo të certifikuara për eksport.

Niveli i punësimit është i ulët, veçanërisht në sektorin formal, ndërsa një pjesë e madhe e fuqisë punëtore është larguar drejt emigracionit apo drejt zonave urbane më të zhvilluara brenda dhe jashtë vendit. Mungesa e kapitalit financiar, e shërbimeve këshilluese dhe e mbështetjes për start-up-et vendore e ka vështirësuar më tej zhvillimin e sipërmarrjes sidomos për të rinjtë dhe gratë.

Megjithatë, Bashkia Has përbën një territor me potencial për zhvillim ekonomik të qëndrueshëm nëse mbështeten format alternative të ekonomisë rurale, si agrobiznesi, kooperativat e vogla dhe sipërmarrjet sociale. Rritja e aksesit në fonde zhvillimore, mbështetja teknike dhe krijimi i një identiteti ekonomik lokal mund të jenë nxitës për rigjallërimin ekonomik të zonës.

Potenciali Turistik dhe Trashëgimia Kulturore

Bashkia Has zotëron një potencial të konsiderueshëm për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm, të bazuar si në resurset natyrore, ashtu edhe në trashëgiminë kulturore dhe etnografike të pasur të zonës. Peizazhet e paprekura malore, pyjet e dendura, burimet ujore, ujëvarat natyrore dhe shtigjet panoramike përbëjnë një bazë të favorshme për zhvillimin e turizmit natyror, të aventurës dhe atij ekologjik. Këto elementë krijojnë kushte ideale për oferta turistike gjithëvjetore, përfshirë ecjen malore, çiklizmin, kampingun dhe guidat natyrore.

Këtu mund të përmendim , Malin e Pashtrikut, Lumin Drin, Bjeshkën e Krumës, Shpellën e Pëllumbave, Shpellën e Dajçit, Kulla e Kurpalëve etj.

Trashëgimia kulturore e Hasit pasqyrohet në elementë arkitektonikë tradicionalë, në ndërtimet me gur, kullat e vjetra, rrënojat historike dhe sidomos në pasurinë e trashëgimisë shpirtërore: zakone, rite, veshje tradicionale, këngë dhe valle që ruajnë identitetin lokal.Kultura autoktone e banorëve, mikpritja dhe mënyra e jetesës tradicionale përbëjnë elementë me vlerë të lartë për zhvillimin e agroturizmit dhe turizmit kulturor.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HAS

Këtu mund të permendim, Kulla e Kurpalëve (tashmë e rikonstruktuar dhe e hapur për vizitorët) dhe një sër kullash tjera tipike hasjane, vendstrehimet e qytetit, pelegrinazhi në Malin e Pashtrikut, dasma hasjane dhe një sër organizimesh të tjera të cilat janë të përvitshme.

Pavarësisht këtyre vlerave të rëndësishme, zhvillimi turistik është ende në një fazë shumë të hershme. Mungesa e një strategjie të integruar të turizmit, infrastruktura e papërshtatshme për vizitorë, mungesa e strukturave të akomodimit dhe e guidave të trajnuara e kufizojnë aksesin dhe qëndrueshmërinë e këtij sektori. Aktualisht mungojnë paketat turistike të strukturuara, qendrat informative dhe sinjalistika orientuese drejt atraksioneve.

Bashkia	Nj.Ami n.	Fshati	Emertimi	Inst.i shpalljes	Nr.vendimit, viti
Has	Golaj	Kostur	Banes Bajram Uka	Min. Ars. Kultures	1886, 10.06.1973
Has	Golaj	Kostur	Banes Mus Hasani	Min. Ars. Kultures	1886, 10.06.1973
Has	Fajza	Vranisht	Banese Dem Ferizolli	Min. Ars. Kultures	1886, 10.06.1973
Has	Golaj	Golaj	Banesa Selim Sadria	Min. Ars. Kultures	1886, 10.06.1973
Has	Golaj	Helshan	Man Çela (Sali Çela)	Min. Ars. Kultures	1886, 10.06.1973
Has	Golaj	Golaj	Banesa Bajram Dauti	Min. Ars. Kultures	1886, 10.06.1973
Has	Golaj	Helshan	Banesa Ibrahim Sadiku	Min. Ars. Kultures	1886, 10.06.1973
Has	Golaj	Kostur	Çardaku Ibrahim Gjoni	Min. Ars. Kultures	Urdherese 08.01.1977
Has	Golaj	Vlahen	Kulle Et hem Kovaçi	Min. Ars. Kultures	Urdherese 08.01.1977
Has	Krume	Q.Kume	**Internati "Muzeu)**	Min. Ars. Kultures	**1886, 10.06.1973**
Has	Krume	Krume	Banesa Adem Pavdeja	Min. Ars. Kultures	Urdherese 08.01.1977

Megjithatë, ekziston një interes në rritje nga banorët lokalë për të investuar në bujtina dhe për të përfshirë trashëgiminë familjare në ofertën turistike. Në këtë drejtim, mbështetja e turizmit të bazuar në komunitet, ngritja e kapaciteteve vendore, krijimi i rrjeteve me destinacione të tjera dhe përfshirja e të rinjve në sektor përbëjnë mundësi reale për të kthyer turizmin në një shtyllë të qëndrueshme të zhvillimit ekonomik të Bashkisë Has.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HAS




Figura 6 - Pamje e Malit të Pashtrikut

Infrastruktura dhe Shërbimet Mbështetëse

Infrastruktura mbështetëse në Bashkinë Has përballet me sfida të shumta që ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e jetës së banorëve dhe në kapacitetin për të zhvilluar aktivitete ekonomike dhe turistike. Rrjeti rrugor është i kufizuar në cilësi dhe shtrirje, me shumë akse që mbeten të paasfaltuara ose të dëmtuara, veçanërisht në zonat e thella rurale që kanë potencial për zhvillim bujqësor dhe turistik.Pjesa dërrmuse e rrugëve të cilat të qojnë në pikat turistike të bashkisë Has janë të pa asfaltuar ku mund të përmendim, rruga Krumë fshati Cahan - Kishaj, rruga e cila të dërgon në zonën me potencialin natyror më të madh të bashkis Has.

Shërbimet bazë si ujësjellësi dhe kanalizimet janë të kufizuara, veçanërisht në fshatrat më të largëta. Shumë zona përballen me mungesë të vazhdueshme të ujit të pijshëm, ndërsa trajtimi i ujërave të ndotura është pothuajse inekzistent. Furnizimi me energji elektrike është i paqëndrueshëm në disa fshatra, duke krijuar vështirësi për banorët dhe sipërmarrësit lokalë. Në fshatra mungon totalisht sistemi i kanalizimeve dhe uji i pijshëm në pjesë më të madhe të fshatrave është me orare të caktuara në përjashtim të atyre fshatrave që kanë burime ujore natyrore të mjaftueshme për furnizim me ujë të pijshëm 24 orë.

Infrastruktura dixhitale është e pazhvilluar dhe qasja në internet me shpejtësi të lartë mbetet e kufizuar në shumë njësi administrative. Kjo ndikon jo vetëm në zhvillimin ekonomik dhe përfshirjen e të rinjve, por edhe në ofrimin e shërbimeve publike dhe mundësinë për të promovuar territorin në mënyrë moderne.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS

Shërbimet publike në përgjithësi janë të përqendruara në qendrën e bashkisë, me qasje të kufizuar në zonat periferike. Qendrat shëndetësore dhe ato arsimore shpesh përballen me mungesë personeli, infrastrukture të amortizuar dhe furnizime të pakta.

Për të mbështetur zhvillimin ekonomik dhe turizmin, nevojiten investime të qëndrueshme në rrjetin rrugor, sistemet bazë të shërbimeve, qendrat informative për turistët, sinjalistikën orientuese dhe infrastrukturën teknologjike. Vetëm përmes përmirësimit të këtyre komponentëve mund të sigurohet një zhvillim gjithëpërfshirës dhe funksional për banorët dhe vizitorët.




Figura 7 - Harta e pikave Turistike

Analiza SWOT

Për të orientuar vendimmarrjen strategjike dhe për të ndërtuar objektiva të qëndrueshme për periudhën 2026 - 2030, Bashkia Has ka kryer një analizë SWOT mbi potencialet dhe sfidat e saj. Kjo analizë synon të japë një pasqyrë të qartë të faktorëve të brendshëm si pikat e forta dhe të dobëta si dhe të faktorëve të jashtëm, si mundësitë dhe kërcënimet që ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin ekonomik, social, mjedisor dhe kulturor të territorit.

Identifikimi dhe vlerësimi i këtyre elementeve është kryer në bashkëpunim me strukturat vendore, përfaqësues të komunitetit, sipërmarrës lokalë dhe aktorë të shoqërisë civile, me qëllim ndërtimin e një baze reale për hartimin e prioriteteve strategjike dhe orientimin e investimeve. SWOT-i i paraqitur më poshtë përfaqëson një diagnozë realiste të gjendjes aktuale dhe një pikënisje për ndërhyrjet zhvillimore në vitet në vijim.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS

Misioni dhe Vizioni

Misioni: Të promovojë zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, social dhe kulturor të territorit të Bashkisë Has, nëpërmjet përmirësimit të shërbimeve publike, fuqizimit të komunitetit lokal, mbrojtjes së trashëgimisë natyrore e kulturore dhe krijimit të mundësive të barabarta për të gjithë qytetarët.

Vizioni 2030: Bashkia Has - një zonë dinamike dhe gjithëpërfshirëse, e njohur për identitetin e saj kulturor, mikpritjen tradicionale dhe potencialin e pasur natyror, që ofron cilësi jetese, zhvillim ekonomik të integruar dhe turizëm të qëndrueshëm në harmoni me mjedisin.

Tabela 6 - Analiza SWOT.

Pikat e Forta (Strengths)	**Pikat e Dobëta (Weaknesses)**
- Trashëgimi natyrore dhe kulturore e pasur	- Infrastruktura rrugore e amortizuar
- Traditë e fortë në blegtori dhe bujqësi	- Shërbime publike të kufizuara
- Komunitet mikpritës dhe vlera të forta lokale	- Nivel i ulët i zhvillimit teknologjik
- Afërsia me tregjet e Kosovës	- Mungesë e strukturave turistike të organizuara
Mundësitë (Opportunities)	**Kërcënimet (Threats)**
- Potencial për zhvillim të agroturizmit dhe turizmit natyror	- Emigrimi i vazhdueshëm i të rinjve
- Mundësi për tërheqje fondesh nga BE dhe IPA	- Varësia nga ndihmat dhe remitancat
- Pjesëmarrja aktive e diasporës	- Mungesa e investimeve të huaja
- Bashkëpunime ndërkufitare me komunat në Kosovë	- Rreziku nga izolimi ekonomik dhe social

*Shpjegim termash, BE - Bashkimi Europian, IPA - Instrument for Pre-Accession Assistance.

Objektivat Strategjike

Zhvillimi Ekonomik Lokal

- Mbështetje për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.
- Promovimi i produkteve lokale.
- Krijimi i një marke "Made in Has". (kjo ne aspektin e produkteve te zones dhe turizmit).

Zhvillimi i Turizmit

- Hartimi i një harte turistike të Hasit.
- Hartimi i Guides Turistike, fletushkave infromuese mbi pikat turistike
- Mbështetje për agroturizmin dhe bujtinat.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HAS

- Organizimi i aktiviteteve kulturore dhe panaireve lokale.
- Markimin e shtigjeve dhe vendosja tabelave orientuese dhe informuese,
- Krijim website për turizmin

Zhvillimi i Infrastrukturës Mbështetëse

- Përmirësimi i aksesit rrugor drejt zonave turistike.
- Vendosja e sinjalistikës turistike.
- Investimi në qendra informacioni dhe guidë turistike.

Edukimi dhe Ndërgjegjësimi

- Trajnime për të rinjtë dhe gratë në sipërmarrje me mbështetjen dhe të organizatave të ndryshme.
- Fushata ndërgjegjësuese për pasuritë natyrore dhe kulturore.
- Bashkëpunim me shkollat për edukim mbi turizmin lokal.

Prioritetet Strategjike për çdo Vit (2026 - 2030)

Tabela 7 - Priroritetet strategjike

Viti	Aktivitetet Kryesore	Objektivi
2026	Hartimi i planeve turistike, trajnime	Zhvillimi i turizmit
2027	Rrjetizimi i prodhuesve lokalë	Zhvillimi ekonomik
2027	Infrastruktura rrugore e turizmit	Infrastrukturë
2026 - 2030	Organizimi i panaireve dhe festivaleve	Promovimi kulturor
2029	Certifikimi i produkteve lokale	Standardizimi
2030	Vlerësimi i planit dhe rishikimi	Monitorim dhe rishikim

Partnerët dhe Palët e Interesuara

Bashkia Has njeh rëndësinë e një angazhimi të koordinuar dhe efektiv me të gjitha palët kyçe në zbatimin e këtij plani strategjik. Për këtë qëllim, identifikohen si partnerë dhe palë të interesuara institucionet dhe aktorët kryesorë që do të kontribuojnë në arritjen e objektivave strategjike dhe zhvillimin e qëndrueshëm të territorit.

Në përputhje me kompetencat dhe rolet përkatëse, Bashkia do të bashkëpunojë ngushtë me institucionet qendrore dhe lokale, organizatat ndërkombëtare dhe donatorët, sektorin privat, shoqërinë civile, si dhe komunitetin vendor.

Ky bashkëpunim do të mbështetet në mekanizma të përhershëm koordinimi, ndarje të përgjegjësive dhe burimeve, si dhe monitorim të përbashkët të rezultateve.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HAS

Përmes kësaj qasjeje, Bashkia synon të sigurojë përfshirjen aktive të të gjitha palëve dhe përmbushjen efektive të objektivave të përcaktuara në këtë plan strategjik.

Aktiviteti	Vlera e Parashikuar në (lekë)
Krijimi i Website për Turizmin	90,000
Markimi i Shtigjeve dhe Tabelave Orientuese	3,500,000
Bjere pajisjesh (dron , aparat fotografik etj)	450,000
	Totali = 4,040,000

Vlerë e përllogaritur për projekte dhe materiale të nevojshme.

Burimet Financiare dhe Mundësitë e Financimit

Zbatimi i objektivave të këtij Plani Strategjik kërkon një mobilizim efektiv dhe të qëndrueshëm të burimeve financiare nga burime të ndryshme. Bashkia Has do të fokusohet në sigurimin dhe menaxhimin e financimeve nëpërmjet burimeve lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare.

Për realizimin e projekteve dhe iniciativave prioritarë, do të përdoren mekanizma të financimit të përbashkët dhe partneritete strategjike, duke përfshirë: buxhetin vendor, programet mbështetëse të qeverisë qendrore, fondet dhe grantet nga Bashkimi Evropian, programet ndërkombëtare të financimit si IPA (Instrument for Pre-Accession Assistance) dhe instrumente të tjera të bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar.

Bashkia do të zhvillojë kapacitete të forta për aplikimin dhe menaxhimin e këtyre fondeve, duke siguruar transparencë, efektivitet dhe përputhshmëri me kriteret ligjore dhe kërkesat e donatorëve.

Monitorimi dhe Vlerësimi

Për të siguruar zbatimin e qëndrueshëm dhe efikas të Planit Strategjik 2026 - 2030, Bashkia Has do të vendosë një mekanizëm të strukturuar të monitorimit dhe vlerësimit, në përputhje me parimet e qeverisjes së mirë dhe transparencës.

Procesi i monitorimit do të realizohet në mënyrë periodike, mbi bazën e treguesve të matshëm për çdo objektiv strategjik, dhe do të përfshijë raportim të rregullt mbi ecurinë, rezultatet dhe sfidat e zbatimit. Të dhënat e mbledhura do të shërbejnë si bazë për analizë krahasimore dhe për përmirësim të ndërhyrjeve në kohë reale.

Vlerësimi do të kryhet në mënyrë të pavarur, në fund të fazave kyçe të zbatimit, me qëllim të evidentimit të ndikimit të ndërhyrjeve, eficiencës së përdorimit të burimeve dhe identifikimit të mësimeve të nxjerra për planifikime të ardhshme.

Bashkia Has do të angazhojë strukturat e saj të brendshme dhe aktorët e jashtëm relevantë për të garantuar një proces gjithëpërfshirës dhe të besueshëm të monitorimit dhe vlerësimit, në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të politikave zhvillimore dhe shërbimeve publike.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HAS

Sektori i Planifikimit të Territorit dhe Urbanistikës

Bashkia Has synon të krijojë një mjedis institucional, ekonomik dhe social për zhvillimin e qëndrueshëm të territorit. Për të realizuar këtë qëllim do të duhet të rishikohet Plani i Pergjitshem Vendorënë (PPV) për zhvillimin e territorit, si dhe Plane të Detajuara Vendore e Sektoriale (PDV) referuar bazes ligjore që i rregullojnë ato.

Ky dokument paraqet një panoramë të përgjithshme të gjendjes ekzistuese të territorit të Bashkisë Has, dhe nevojës së hartimit të dokumentit të sipër përmendur, krahas kërkesës ligjore për hartimin e këtij dokumenti. Në këtë dokument paraqitet gjithashtu dhe plani i veprimeve që do të ndërmerren deri në miratimin përfundimtar të planit strategjik të Bashkisë Has.

Për të realizuar këta objektiva, do të zbatohen një sërë politikash. Një ndër to është nisja e punës për hartimin dhe miratimin e Planit Strategjik, si përkthim i strategjisë vendore të zhvillimit në territor dhe bazë për zhvillimin e qëndrueshëm, investimet dhe kontrollin e territorit. Planit Strategjik është planifikimi, që shtrihet në të gjithë territorin e Bashkisë Has, në vetvete është një veprimtari ndërdisiplinore për planifikimin e përdorimit të projekteve te hartuara nga bashkia,

Në planin afatmesëm kërkohen investime në këto fusha

Nr.	Emertimi I projektit	Fusha në të cilen kërkohet	vendndodhja	impakti
1	Dizajnim, rimodelim, sotuku I pallateve dhe hapsirave publike (parqe e, lulishte) qyteti Krumë	Nderhyrje urbane	qyteti Krumë	Banoret e qytetit Krumë
2	Sitemim total I lagjes "Kodra e Madhe"(Rrjeti nentokësor inxhinjerik, infrastrukturë rrugore, trotuare, gjelbrim).	Nderhyrje urbane ifrastrukturë	L. "Kora e Madhe"	Lagje e Qytetit Krumë
3	Sistemim Asfaltim, rrugeve te fshatrave , Nj. Administrative	Infrastrukturë rrugore	Njesitë Administrative	banoret e bashkisë
4	Rehabilitim I rrjetit ujites dhe veprave ujore	Sistemi bujqisisë	Teritori, Bashkia Has	Fermerët e bashkisë
6	Rehabilitim I terreneve sportive, godina historike, socialkulturore	Tuizem, kulturë, sport	Bashkia Has	banoret e bashkisë

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HAS

7	Ndertim I lerave per ujë të pijshëm, zona e bjeshkes Pashtrikut, Kishaj per bagëtinë.	Fusha e blegtorisë	Nj.Administrative Gjinsj, Krumë	Blegtoret e zones
8	**Nderhyrje ne riaftesim të zonave pyjore të mrojtura .**	**Sektori I pyjeve**	**Teritori, Bashkia Has**	**Permiresim**
9	Ndertim I Shtigjeve Malore	Sektori I pyjeve	Teritori, Bashkia Has	Turizem malor
10	**Planifikim I zonave per projekte prodhim alternativ te energji elektrike *Panele djellor)etj.**	**Sektori I energjisë**	**Teritori, Bashkia Has**	**rritje ekonomike, punesim**

Ky proces do të bazohet në Ligjin 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, VKM Nr. 686, datë 22.11.2017 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit" si dhe legjislacionit sektorial në fuqi.

Lista e projekteve të gatshme për financim.

Nr.	Emertimi i Projektit	Vlera e preventivit Lekë	Kerkesë financim viti 2024-2026
	Ndërtim godina e re Bashkia Has	78,368,187	-
	Sistemim i lumit Kruma(Vrella)	152,423,115	-
	Asfaltim Rruge, trotuare lagje e Rrafshit Krume Gec, Shet ,Peçak.	104,521,221	-
	Sistemim asfaltim I rrugeve te fshatit Gajrep	189,495,664	-
	Ndertim Pedonale, në kuroren e diges rez. pla Krumë,	45,285,756	-
	Sistemim asfaltim rruga fshati Nikoliq	302,402,327	-
	Sistemim asfaltim rruga Krume-Cahan	827,000,616	-
	Sistemim asfaltim rruga Nj.A. Gjinaj	94,958,415	-
	Sistemim asfaltim rruga fshati Helshan-Kosturr.	368,572,534	-
	Rruga Kam-Qaf Prush (Projekt I perbashket bashkite, Tropoje-Has)	1,261,667,285	-
	Rikonstruksion I Rruges Lagje Çunaj, fshati Letaj	17,732,412	-
	Sistemim asfaltim Rruga Lagje Pla (Rada) Krume	109,141,032	-
	Sistemim asfaltim rruga fshati Myç Has	20,123,320	-

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HAS

Ministria e Arsimit dhe Sporteve		
Ndertimi i palestres se shkolles 9-vjecare Helshan".	11,272,450	-
Ndertim shkolle e re fshati Vhane.	104,682,130	-
Rehabilitim fusha e futbollit Krume.	38,298,359	-
Ndertim Muzeu Etnografik Krume, Has.	31,200,350	-
Rikonstruksion I shkolles se mesme te bashkuar "Arif Zeqiri" Golaj	68,225,012	-
Fushe polivalente gjimnazi Krume	11.000.000	-
Drejtoria e Pergjithshme Ujesjelles-kanalizime	**Proces tederi**	
Vendosje e matesave te ujit te Pishem qyteti Krume.	59,572,516	-
KUZ "Kodra e Madhe" krume	**Ne ndertim**	
Rehabilitim "Ushqyesi rezevuari Llakaj'	56,960,809	-
Rehabilim "Skema Ujitese rez. Llakaj".	74,310,229	-
Rehabilitim diga rez. "Qarr-2"	90,561,678	-
Riparim I rezervuarit Tobël	24,053,597	-
Kanali vadites fshati Dobrune (nga pompa ngr. Mekanike)	9,772,400	-
	Totali në lekë = 4,140,601,414	

Shenim: Të gjitha projektet e mësiperme jane pjese e kerkeses per financim pranë instiucioneve prkatese dhe F.SH.ZH.

Qëllimi i këtij plani

Duke ndjekur objektivat e përgjithshme të Ligjit për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit si dhe objektivat strategjikë kombëtare :

- Zhvillimin, futjen dhe aplikimin praktik të metodave planifikuese urbane lokale të detyrueshme që t'i përshtaten tregut;
- Kultivimin dhe formulimin e veprimtarive të partneritetit ndërmjet bashkisë ndërmarrjeve/agjensive të infrastrukturës, zhvilluesve, pronarvë të tokës, pushtetit qëndror dhe grupeve të tjera të interesit nëpërmjet një proçesi konsultimesh dhe pjesëmarrjes aktive;

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HAS

- Rritjes së kapacitetit të planifikimit, kontrollit të zhvillimit dhe menanxhimit të tokës në departamentet përkatesë të pushtetit lokal.

Objektivat

- Balancimi i nevojave dhe interesave kombëtare e vendore për zhvillimet në territor;
- Krijimi i kushteve për një zhvillim të qendrueshëm në territor;
- Rregullimi i përdorimeve të tokës, intensitetin e shtrirjs së ndërtimit në sistemet natyrore, bujqësore dhe urbane të territorit;
- Planifikimi i programeve dhe masave për të garantuar rigjenerimin urban, mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qendrueshëm të burimeve natyrore, të tokës së kultivueshme, pejsazheve dhe hapesorave te gjelbra;
- Rregullimi i vendndodhjes dhe programeve për infrastrukturën publike e servitutet publike;
- Rregullimi i ruajtjes, perdorimit të zonave të mbrojtura natyrore dhe historike;

Rrugët kombëtare, (Akse Kombëtare rrugore që përshkojnë territorin e Bashkisë, apo propozime nga Bashkia për rrugë të reja të cilat lidhen me këto akse.

Kukes - Krume 28.5 km

Krume - Qafe Prushi 16.5 km

Resurset hidrike janë një pasuri e konsiderueshme. Burimet hidrike nëntokësore janë në formën e burimeve të vogla dhe të kufizuara në numër. Në bjeshkët e Krumës (Cahanit) kanë origjinën disa burime ujore karakteristike të zonës. Vrella e Krumës është një burim i madh ujor nëntokësor, nga i cili furnizohet qyteti dhe disa fshatra përreth me ujë te pishem, eshte ne studim per ndertimin e nje Hidrocentrali. Gurra e Domajve është një tjetër burim karakteristik me ujë të pastër e të kristaltë. Për shfrytëzimin e këtij burimi në fillim të viteve '70 u ndërtua një HC me fuqi 30 kw/orë që aktualisht nuk ekziston më, por ka nisma për rindërtimin e tij.

Linjat Elektrike qe pershkojne Territorin e Bashkise jane:

1. Linja te Tensionit Mesem 171 Km
2. Linja te Tensionit Ulet 158 Km
3. Kabina Elektrike 163 Cope

Hidrocentrali **"Perollaj"**, ne pellgun ujembledhes tr perroit te Bexhmilles Njesia Administrative Golaj Bashkia Has, **me vendim nr. 3, date 05.05.2015 i KKT-se**.

Instalimet e infrastrukturës kombëtare, infrastruktura e komunikimit elektronik: nuk ka **Zhvillimet në zonat ushtarake** Nuk ka.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HAS

Nr	Emri i diges	Bashkite	E	N	Viti i ndertimit	Lartesi e diges ne m	Klasifikimi digave
12	Qarr 1	HAS	20.38508278	42.26470194	1965	27	E madhe
3	Llakaj	HAS	20.39943972	42.21388583	1965	21	E madhe
4	Letaj	HAS	20.37611111	42.29666667	1968	22	E madhe
5	Qarr 2	HAS	20.3881275	42.27541861	1970	27	E madhe
6	Vranisht	HAS	20.37916667	42.16777778	1972	27	E madhe
7	Tobel	HAS	20.33379694	42.12091806	1973	27	E madhe
8	Golaj	HAS	20.38222222	42.24111111	1974	18	E madhe
9	Helshan 4	HAS	20.27532333	42.22378944	1983	18	E madhe
10	Kostur	HAS	20.24204306	42.20430583	1986	24	E madhe
11	Tregtan 3	HAS	20.33611111	42.14361111	1982	32	E madhe
12	Dobrun	HAS	20.41790361	42.27415167	1990	36	E madhe
13	Fajza	HAS	20.384722	42.171944	1971	16	E vogel
14	Tregtani 1	HAS	20.3425	42.136944	1966	11	E vogel
15	Tregtani 2	HAS	20.3425	42.136944	1969		E vogel
16	Golaj 2	HAS	20.385556	42.247222		12	E vogel
17	Golaj 3	HAS	20.386389	42.232222		13	E vogel
18	Helshan 1	HAS	20.274444	42.223611	1966		E vogel
19	Helshan 2	HAS	20.277222	42.224167	1966		E vogel
20	Helshan 3	HAS	20.282222	42.219722	1966		E vogel
21	Nikoliq 1	HAS	20.405278	42.241111	1975	8	E vogel
22	Nikoliq 2	HAS	20.410833	42.243333	1975	10	E vogel
23	Bera	HAS	20.419167	42.207222	1966	12	E vogel

Për qëllime bujqësore, para viteve '90, në Has janë ndërtuar 24 ujëmbledhës (rezervuarë), të cilët zënë një sipërfaqje prej 50 ha dhe kanë një kapacitet ujëmbledhës 9.4 milion m^3 ujë. Shfrytëzimi i tyre është i kufizuar për shkak të amortizimit të sifonëve, veprave të furnizimit dhe të shkarkimit, si dhe të shkatërrimit të kanaleve vaditëse.

Bazuar në rezultatet e analizës, do të hartohet Strategjia Terrioriale e Zhvillimit të Bashkisë. Është e nevojshme që programet publike për të promovuar dhe akomoduar zhvillimin e ardhshëm të bashkisë të bazohen në parashikimet për rritjen e ardhshme të popullsisë. Parashikimet për popullsinë mundësojnë vlerësimin e investimeve të nevojshme për të akomoduar nevojat dhe kërkesat e popullsisë së ardhshme për strehim, shërbime publike, punësim, dyqane, aktivitete rekreative, etj, si dhe mobilitetin. Megjithatë, parashikimet për rritjen e popullsisë nuk përbëjnë një bazë të mjaftueshme për planifikimin e zhvillimit të ardhshëm. Çdo dokument zhvillimi strategjik paraprihet nga një vizion. Hartimi i një vizioni që do të përfshijë në vetevete të gjithë spektrin e çështjeve që i përkasin këtij projekti, është një nga sfidat kryesore .

Planit do të përmbajë përkufizimet dhe rregulla për çdo njësi, rregulla për infrastrukturën, rregullat për ruajtjen e mjedisit, peizazhit, burimeve natyrore dhe objekteve të trashëgimisë kulturore, etj.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS

Drejtoria e Financës/ Buxhetit/ Taksave dhe Tarifave vendore

Sektori i Taksave dhe Tarifave

Ky plan strategjik ka për qëllim forcimin e administrimit të të ardhurave vendore nëpërmjet përmirësimit të sektorit të tatim-taksave në Bashkinë Has. Duke u përballur me sfida të burimeve njerëzore dhe financiare të kufizuara, plani synon të sigurojë një sistem efikas dhe të drejtë taksimi për të kontribuar në zhvillimin ekonomik dhe social të qëndrueshëm të bashkisë.

Analiza e Gjendjes Aktuale

Sektori përballet me sfida si: mungesa e stafit të trajnuar, mungesa e një sistemi të unifikuar për identifikimin e plotë të subjekteve tatimore, duke shkaktuar humbje të ardhurash nga bizneset e paregjistruara,regjistrat të papërditësuar të pasurive të paluajtshme, gjë që pengon vlerësimin e saktë të taksave dhe një borxh të lartë të pambledhur.

- Të ardhurat tatimore nuk përmbushin potencialin real të territorit.
- Informaliteti dhe mungesa e regjistrave të azhurnuar ndikojnë negativisht në mbledhjen e taksave.
- Është e nevojshme të forcohet bashkëpunimi me sektorë të tjerë

Vizioni, Misioni dhe Objektivat Strategjike

Vizioni

"Një sistem tatimor lokal i drejtë, efikas dhe transparent, që mbështet zhvillimin e qëndrueshëm të Bashkisë Has."

Misioni

"Të rrisim të ardhurat vendore përmes një administrimi profesional dhe partneriteti me qytetarët."

Objektivat Strategjike

1. Rritja e të ardhurave vendore përmes zgjerimit të bazës tatimore.
2. Zvogëlimi i informalitetit dhe përmirësimi i regjistrimit të subjekteve.
3. Forcimi i kapaciteteve të stafit.
4. Digjitalizimi i shërbimeve dhe lehtësimi i aksesit të qytetarëve.
5. Rritja e transparencës dhe ndërgjegjësimit publik.

Plani i Veprimit (2026 - 2030)

- Identifikimi dhe regjistrimi i subjekteve të paregjistruara.
- Azhurnimi i regjistrave të pasurive dhe njësive ekonomike.
- Nxitja e pagesave vullnetare dhe vendosja e marrëveshjeve për borxhet.
- Organizimi i trajnimeve të rregullta për stafin.
- Promovimi i shërbimeve online dhe edukimi financiar i qytetarëve.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HAS

Objektivi	Veprimet Kryesore	Afati	Përgjegjësit	Treguesit e Performancës
1. Rritja e të ardhurave	Identifikim i subjekteve të paregjistruara; aktualizim i regjistrave; kontroll në terren	2026-2031	Sektori Tatimeve + Urbanistika	+10% e të ardhurave çdo vit
2. Zvogëlimi i borxheve	Dërgim paralajmërimesh, marrëveshje për pagesë me këste, masat ligjore	2026–2028	Sektori Tatimeve + Juridik	20% ulje borxhi në 3 vite
3. Rritja e kapaciteteve	Trajnime për taksat, përdorimin e sistemit elektronik, legjislacionin	Çdo vit	BN + Drejtuesi Sektorit	100% e stafit të trajnuar
4. Digjitalizimi	Lehtësim i aplikimeve online, akses në informacion të qartë për qytetarët	2026–2027	IT + Tatime	Zhvillimi i platformës për e-shërbime
5. Komunikimi publik	Fushata ndërgjegjësimi për detyrimet tatimore, takime me biznesin lokal	Çdo vit	Tatime + PR	2 fushata në vit

Monitorimi dhe Vlerësimi

Monitorimi i zbatimit të planit do të realizohet përmes raporteve vjetore, analizave të performancës dhe treguesve kyç si:

- Rritja e të ardhurave çdo vit.
- Zvogëlimi i borxheve të prapambetura.
- Numri i subjekteve të reja të regjistruara.
- Kënaqësia e qytetarëve me shërbim

Sektori Juridik

Sektori juridik është një strukturë mbështetëse që ka për detyrë të sigurojë zbatimin e ligjshmërisë në të gjitha veprimet e bashkisë, duke përfshirë:

- Hartimin dhe kontrollin ligjor të akteve dhe vendimeve.
- Përfaqësimin ligjor në gjyqe dhe çështje administrative.
- Këshillimin juridik për strukturat vendimmarrëse (Këshilli Bashkiak, Kryetari, Drejtoritë).

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HAS

- Mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit në marrëdhëniet me qytetarët dhe institucion
- Digjitalizimi i dokumentacionit ligjor dhe krijimi i arkivës juridike elektronike.
- Rritja e transparencës dhe llogaridhënies për vendimmarrjen ligjore

Ky hap përfshin identifikimin e rolit dhe përgjegjësive kyçe të sektorit juridik në funksionimin e bashkisë.

- Rritja e efikasitetit në ofrimin e shërbimeve ligjore për departamentet e tjera të bashkisë.
- Sigurimi i përputhshmërisë ligjore të të gjitha vendimeve administrative.
- Përmirësimi i transparencës ligjore dhe ndihmës për qytetarët.

Analiza e gjendjes aktuale

Sektori juridik bën një vlerësim të brendshëm dhe të jashtëm për të identifikuar:

- **Forcat** staf i kualifikuar, përvojë ligjore, bashkëpunim me institucionet.
- **Dobësitë** mungesë teknologjie, staf i kufizuar, ngarkesë e lartë pune.
- **Mundësitë** trajnime, projekte të mbështetura nga donatorë.
- **Kërcënimet** ndryshime të shpeshta në legjislacion, presione politike.

Përcaktimi i objektivave

Këto janë objektiva afatgjatë që e orientojnë sektorin juridik drejt përmirësimit të shërbimeve.

Objektivat duhet të jenë **SMART** (Specifikë, të Matshëm, të Arritshëm, të Rëndësishëm dhe të Kufizuar në kohë).

Duke pasur obektivat si:

Sigurimi i një procesi të standardizuar për rishikimin e të gjitha akteve normative.

Krijimi i një baze të dhënash për dokumentacionin ligjor të bashkisë.

Rritja e aksesit të qytetarëve në ndihmën ligjore të ofruar nga bashkia.

Hartimi dhe rishikimi i të gjitha kontratave të bashkisë brenda 10 ditëve nga marrja në shqyrtim.

Krijimi i një arkive digjitale për dokumentet ligjore deri në fund të vitit.

Ofrimi i ndihmës ligjore për qytetarët një ditë në javë.

Zhvillimi i veprimeve dhe masave konkrete

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HAS

Për çdo objektiv përcaktohen aktivitetet, përgjegjësit dhe afatet.

Çdo qëllim strategjik ndahet në objektiva specifikë dhe masa për zbatim.

Qëllimi	Objektivi	Masa	Afati	Përgjegjës
Standardizimi i procedurave ligjore	Rishikimi i të gjitha kontratave ekzistuese	Hartimi i një liste kontrolli ligjore	3 muaj	Juristi i sektorit
Digjitalizimi i dokumenteve	Krijimi i arkivës elektronike	Trajnim dhe blerje softueri	6 muaj	Koordinatori IT + Sektori Juridik
Ndihma për qytetarët	Ofrimi i shërbimit ligjor një herë në javë	Caktimi i një dite fikse dhe promovimi publik	Nje dite ne jave	Juristi përgjegjës për ndihmën ligjore

Indikatorët e Performancës

Këta tregojnë suksesin apo dështimin në zbatimin e planit.

Përqindja e vendimeve të bashkisë të kontrolluara ligjërisht përpara miratimit.

Kohëzgjatja mesatare e dhënies së opinionit ligjor për një çështje.

Numri i qytetarëve që marrin ndihmë ligjore nga bashkia në vit.

Monitorimi dhe Vlerësimi

Përcaktohen indikatorët e performancës dhe mekanizmat e raportimit.

Mbikëqyrësit shikojnë:

- Raporte 6-mujore të zbatimit dërgohen te Drejtoria e Përgjithshme.
- Rishikim vjetor i planit bazuar në ndryshimet ligjore ose nevojat e reja.
- Raporti final i zbatimit i publikohet edhe publikut.

Rishikimi Periodik i Planit

Plani strategjik duhet të rishikohet periodikisht (p.sh. çdo vit) për të reflektuar ndryshimet ligjore, administrative dhe operacionale.


Migracioni dhe Diaspora

Analize mbi Migracionin dhe Diasporën në Has

Hasi është një nga zonat që historikisht ka përjetuar nivele të larta migracioni, si të brendshëm ashtu dhe ndërkombëtar. Megjithëse të dhënat statistikore të detajuara për migracionin dhe diasporën në Has shpesh janë të kufizuara dhe jo gjithmonë të përditësuara zyrtarisht, kjo për shkak se nuk ka të dhëna zyrtare në nivel Bashkie specifike si Hasi por ka disa burime të besueshme dhe

fakte të njohura që mund të japin një pasqyre të asaj që njihet si "plagë" për Hasjanet që është Emigracioni.

Migracioni nga Hasi drejt vendeve të huaja ka qenë vecanërisht i lartë pas viteve '90, pas rënies së sistemit komunist. Shtetet më të zakonshme ku kanë emigruar qytetarë e Hasit janë: Kosova (historikisht, për shkak të lidhjeve familjare e etnike), Gjermania, Zvicra, Austria, Italia, SHBA dhe Britania e Madhe. Në vitet e fundit, ky fenomen ka vazhduar dhe në disa aspekte është thelluar. Britania e Madhe dekaden e fundit shënon rritjen me të madhe si shteti më i përzgjedhur nga qytetarët Hasjane për të emigruar ku sipas Net migration dhe disa organizatave tjera rreth 4800 qytetare(shifër jozyrtare) nga Hasi jetojnë në Mbretërine e Bashkuar. Emigracioni nga Hasi ka qenë dhe mbetet i vazhdueshëm pavarsisht politkave, ndërhyrjeve dhe objektivave të ndërmarra nga disa organizata si IOM e GIZ. Përvec Britanise, pas vitit 2021emigracioni ka marrë një formë me të organizuar dhe më të gjerë drejt vendeve te tjera të BE-se si Gjermania dhe Italia. Emigracioni në këtë zonë është shumë i theksuar, nuk gjen një familje që të mos ketë emigrant, në disa raste 80% e anëtarëve të familjes kanë ikur në emigrim. Rreth 1 në 5 familje ka anëtare që jetojnë ose punojnë jashtë vendit. Qyteti i Hasit po hyn në një cikël të shpejtë boshatisjeje. Teksa popullsia e re në moshë është në rënie të shpejtë, në anën tjetër, emigracioni i të rinjve po përforcohet më tej, në vend që të ulet. Mbi 30-40% e të rinjëve (mosha 18-35 vjec) kanë emigruar në 5 vitet e fundit. Disa nga shkaqet kryesore që kanë sjellë largimin në masë të qytetarëve hasjane kryesisht moshave të reja, janë të renditura në grafikun më poshtë:



Ndërsa Hasi vuan prej vitesh emigracionin masiv prej shkaqeve te cituara me sipër, kjo ka sjell dhe pasojat ku sipas të dhënave të INSTAT dhe studimeve të diasporës; rreth 30-40% e popullsisë së Hasit jeton ose ka jetuar jashtë vendit për periudha afatgjata; disa fshatra të Hasit janë thuajse të zbrasur gjatë vitit, sidomos në periudha dimërore, sepse shumica e familjeve jetojnë jashtë dhe kthehen vetëm në verë. Numri i lindjeve po ulet cdo ditë e më shumë duke shënuar shifra alarmante

BASHKIA HAS

për qytetin tone. Për shkak të këtyre lindjeve ka rënë ndjeshëm numri i nxënësve në disa shkolla të cilat rrezikojnë të mbyllen, ndërsa në disa shkolla mësimi zhvillohet në klasa kolektive dhe ka klasa që nuk parashikohet të fillojë klasa e parë për efekt të fëmijëve që nuk janë. Ky është fenomen i dhimbshëm por është evident në Bashkinë tonë. Megjithatë, më poshtë do të përmbledh në një tabele pasojat e tjera të emigracionit në Has sipas të dhënave nga INSTAT dhe Anketës Kombëtare të Migracionit në familje.

PASOJAT	PËRSHKIMI
ZBRAZJA E POPULLSISË DHE PLAKJA DEMOGRAFIKE	Largimi i të rinjëve = fshatra të zbrazura, plakje e popullsisë, shkolla të boshatisura ku nga 2019 e ne vazhdim ka rënie te nr të nxënësve në shkollat 9-vjecare dhe gjimanz si dhe dy shkolla janë mbyllur plotësisht përkatesisht shkolla "Dome" dhe shkolla "Kishaj"
MUNGESA E FUQISË PUNËTORE DHE E RINISË	Mungesa e të rinjëve në punë.
SHKRETIMI I JETËS SOCIALE DHE KOMUNITARE	Rënia e aktiviteteve kulturore dhe komunitare.
NDRYSHIME NË STRUKTURËN SOCIALE DHE FAMILJARE	Familje të ndara, fëmije të rritur pa prindër.
FENOMENI I "EMIGRIMIT CIKLIK"	Khim i përkohshëm – mungesë përfshirjeje të diasporës në zhvillim afatgjatë.
RËNIA E INVESTIMEVE PUBLIKE DHE PRIVATE	Pakësim i investimeve për shkak të mungesës së qëndrueshmërisë.
BOSHATISJA E PRONAVE DHE PASURIVE FAMILJARE	Shtëpi dhe toka të braktisura për pjesën me të madhe të vitit.
BRAIN DRAIN	Emigrimi masiv i njerëzve të kualifikuar ku 53% (shifër jozyrtare) e të ikurve jashtë dhe brenda vendit janë me arsim të mesëm të lartë në kërkim të mundësive më të mira.

Një ndër pasojat e shumta të emigracionit janë dhe Remitancat. Vlerësime për Hasin (jo zyrtare, por të referuara nga studime lokale) vlerësojnë që diaspora hasjane është aktive dhe kontribuon me dërgesa të rregullta financiare (remitanca) për familjet e tyre në Has. Disa burime vlerësojnë që deri në 70% e familjeve në Has marrin ndihmë ekonomike nga të afërmit në emigrim. Pra, remitancat janë një burim i rëndësishëm i të ardhurave për të mos thënë jetike për familjet Hasjane. Këto remitanca përdoren kryesisht për përmisimin e kushteve të jetesës, ndërtimin e shtëpive dhe investimeve të vogla në ekonomi familjare. Megjithatë, vlen të theksohet që këto remitanca përvec

se ndikimit të drejtëpërdrejt në mirëqenien e familjeve, nuk janë përdorur në mënyrë të gjerë për investime strategjike që do të krijonin punësim të qëndrueshëm dhe zhvillim ekonomik afatgjatë në Has.

TREGUESI	VLERËSIMI
PESHA E FAMILJEVE QË MARRIN REMITANCA	50 -70%(në varësi të zones Brenda Hasit)
PËRDORIMI KRYESOR I REMITANCAVE	Konsum, ndërtim, arsim, shëndetësi
TË ARDHURA VJETORE PËR FAMILJE	Vlerësohen në 2000 - 5000 euro/familje(jo zyrtare)
TREGUES INDIREKT	Remitancat mbeten burimi kryesor i mbijetesës për shumë familje në Has

Sipas një studimi nga **Co - Plan(2021)** Hasi është identifikuar si një nga bashkitë me varësi të larte nga remitancat me një ekonomi jo prodhuese.

Në të njëjtën kohe krahas emigracionit kemi po aq të përhapur dhe migracionin e brendshëm. Nëse **emigracioni** është procesi kur një person largohet nga vendi i tij i origjinës për të jetuar në një vend tjetër, **migracioni brendshëm** përshkruan levizjen e njerëzve nga një qytet në një tjetër brenda të njëjtit vend.

Referuar migracionit të brendshëm sipas të dhënave nga Anketa Kombëtare e Migracionit në familje, migrimi i brendshëm neto është:-166 banorë. Kjo tregon se në Has ka largim të konsiderueshëm drejt qyteteve të mëdha brenda shqiperisë si Tirana, Durrësi dhe Shkodra. Ky lloj migracioni është më i përhapur te të rinjtë që largohen për arsye studimi apo pune dhe nuk kthehen më. Shkaqet e migracionit të brendshëm janë po të njëjtat me ato të emigracionit ndërkombëtar si; papunësia, varferia, arsimi dhe perspektiva e të rinjëve sepse shumë të rinj nuk shohin të ardhme në vendlindje dhe kërkojnë arsimim apo punësim në qytete më të mëdha dhe që ofrojnë më shumë mundësi.

Hasi është duke përjetuar zhvillime alarmante në humbjen e popullsisë, për shkak të emigracionit të lartë. Edhe pas tri dekadash nga ndryshimi i sistemit, flukset emigratore janë të larta, duke e vënë perspektivën e zhvillimit të vendit në një rrugë pa krye. Ky qytet pavarsisht peizazhit malor me një faunë të pasur dhe kullave arkitektonikë qe e karakterizojnë zonën po kthehet në një parajsë të braktisur. Prej politikës, varfërisë dhe sistemit shumë pak ose aspak social, popullsia po zhvendoset dhe po deformohet jeta sociale e qytetit tonë. Duke qenë para një realiteti të tillë bashkia Has ka si qëllim kryesor të krijoje një qasje të strukturuar dhe afatgjatë për menaxhimin e migracionit dhe forcimin e lidhjeve me diasporën nëpërmjet këtyre prioriteteve:

- Hartimi i një **Plani Lokal për Migracionin**, i integruar në strategjitë zhvillimore të Bashkisë.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HAS

- Krijimi i një **Zyre për Migracionin dhe Diasporën** si strukturë e posaçme për koordinimin.
- Zhvillimi i një **platforme digjitale** për komunikim dhe shërbime online për diasporën.
- Organizimi i **forumeve dhe takimeve vjetore** me komunitetin e diasporës.
- Nxitja e **investimeve të diasporës** në bujqësi, turizëm dhe biznese të vogla.
- Ofrimi i **trajnimeve dhe orientimit për punësim** për migrantët e kthyer dhe familjet e tyre.
- Promovimi i **eventeve kulturore dhe edukative** për ruajtjen e identitetit lokal dhe përfshirjen e diasporës.

Zyra për Integrimin Europian

Vizioni

Bashkia Has synon të bëhet një model i mirëqeverisjes vendore që përfiton në maksimum nga procesi i integrimit europian, duke rritur transparencën, eficiencën dhe bashkëpunimin ndërkombëtar në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm lokal.

Misioni

Zyra e Integrimit Europian udhëheq procesin e përafrimit të Bashkisë Has me standardet dhe praktikat më të mira të Bashkimit Europian, duke forcuar kapacitetet institucionale, përmirësuar shërbimet ndaj qytetarëve dhe krijuar mundësi për projekte zhvillimore me financime europiane.

Objektivat Strategjikë

1. **Forcimi i kapaciteteve institucionale të Bashkisë Has** për të përmbushur kërkesat e integrimit europian.
2. **Rritja e përfitimit nga fondet e BE-së dhe programet ndërkufitare** për zhvillim ekonomik, social dhe infrastrukturor.
3. **Përmirësimi i transparencës dhe qeverisjes vendore** sipas standardeve të BE-së.
4. **Promovimi i bashkëpunimit ndërkufitar dhe ndërkombëtar**, veçanërisht me komunat partnere në rajon.
5. **Ndërgjegjësimi dhe përfshirja e qytetarëve** në procesin e integrimit europian.

Prioritetet Kryesore dhe Masat

1. Kapacitete Institucionale

- Trajnime për administratën vendore mbi acquis communautaire dhe praktikat e BE-së.
- Hartimi i manualeve të brendshme të përafruara me standardet europiane.
- Krijimi i një "Njësie të Projekteve Europiane" brenda Zyrës së Integrimit.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HAS

2. Fonde dhe Projekte Europiane

- Identifikimi i burimeve të financimit nga BE (IPA III, Interreg, Horizon Europe, Erasmus+).
- Hartimi i projekteve konkrete për infrastrukturë, turizëm, bujqësi dhe kulturë.
- Ngritja e një databaze të projekteve të financuara dhe monitorimi i zbatimit të tyre.

3. Qeverisje dhe Transparencë

- Zbatimi i parimeve të qeverisjes së mirë dhe transparencës.
- Digjitalizimi i shërbimeve për qytetarët.
- Forcimi i pjesëmarrjes së komunitetit në vendimmarrje.

4. Bashkëpunim Ndërkufitar dhe Rajonal

- Zhvillimi i partneriteteve me bashki në Kosovë, Mal të Zi dhe Maqedoninë e Veriut.
- Pjesëmarrje aktive në rrjete ndërkombëtare të komunave.
- Organizimi i forumeve ndërkufitare për zhvillim ekonomik dhe kulturor.

5. Ndërgjegjësim dhe Edukim Europian

- Organizimi i aktiviteteve sensibilizuese për qytetarët mbi integrimin europian.
- Futja e moduleve informuese për BE-në në shkolla.
- Krijimi i një "Ditë Europiane" në Has me aktivitete kulturore, rinore dhe edukative.

Njëia Administrative Golaj

Njësia Administrative Golaj një nga njehsit administrative të bashkisë të bashkisë Has dhe përfshin 12fshatra, Golaj, Nikoliq, Bardhaj, Perollaj, Vlahen, Letaj, Peraj, Dobrune, Zgjeç, Qarr, Helshan, Kosturr me karakter kryesisht, njehsia ka një popullsi prej 8139 banorësh. Zona karakterizohet nga terren kodrinoro - malor, me pasuri natyrore të lidhura me pyje, kullota dhe burime ujore. Pozita kufitare i jep rëndësi të veçantë ekonomike dhe gjeostrategjike, duke krijuar mundësi për bashkëpunim ndërkufitar me Kosovën.

2. Ekonomia dhe burimet

Ekonomia bazohet kryesisht në:

- **Bujqësi dhe blegtori**: kulturat bujqësore tradicionale dhe rritja e bagëtive janë burimi kryesor i të ardhurave.
- **Pyje dhe kullota**: me potencial për shfrytëzim të qëndrueshëm dhe zhvillim të aktiviteteve ekonomike si bletaria, bimët mjekësore dhe drurët frutorë.
- **Migracion dhe remitanca**: një pjesë e popullsisë ka të ardhura nga emigracioni, të cilat ndikojnë në zhvillimin lokal.

3. Infrastruktura dhe shërbimet

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HAS

- **Rrugët**: nevojë për përmirësim të lidhjes së brendshme ndërmjet fshatrave dhe lidhjes me qendrën e bashkisë.
- **Uji dhe kanalizimet**: kërkohet investim në sistemet e furnizimit me ujë të pijshëm dhe ujitjes.
- **Shërbimet sociale**: shkollat dhe qendrat shëndetësore ekzistojnë, por kanë nevojë për modernizim dhe staf të specializuar.

4. Trashëgimia kulturore dhe turizmi

- Zona ka vlera historike, tradita kulturore dhe një identitet të fortë të trashëguar në muzikë, valle e kulinari.
- Potencial për zhvillimin e **turizmit malor dhe rural**, sidomos në lidhje me natyrën e paprekur dhe mikpritjen tradicionale.

5. Sfida kryesore

- Largimi i të rinjve dhe rënia demografike.
- Mungesa e investimeve private dhe publike.
- Infrastruktura e pamjaftueshme.

6. Objektivat strategjike

- **Rritja e qëndrueshme ekonomike** përmes mbështetjes së bujqësisë moderne, blegtorisë dhe produkteve bio.
- **Përmirësimi i infrastrukturës** rrugore, ujore dhe energjetike.
- **Forcimi i kapitalit njerëzor** me arsim dhe shëndetësi cilësore.
- **Zhvillimi i turizmit rural dhe kulturor**, duke e lidhur Golajn me itineraret turistike të Hasit dhe rajonit.
- **Bashkëpunimi ndërkufitar** me komunat e Kosovës për tregti, turizëm dhe kulturë.

Njësia Administrative Gjinaj

Njësia Administrative Gjinaj, Bashkia Has.

Njësia Administrative Gjinaj e Bashkisë Has është një nga tre njësitë administrative të Bashkisë Has.

Njësia Administrative Gjinaj, përbëhet nga 6 (gjashtë) fshatra: Gjinaj, Pusi Thatë, Domaj, Myç Has, Pogaj dhe Kishaj.

Popullsia e Njësisë Adm.Gjinaj është 1360 banorë, 215 familje nga këto159 familje trajtohen me ndihmë ekonomike.

- Fshati Gjinaj ka 370 banorë. Trajtohen me ndihmë ekonomike 43 familje.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HAS

- Fshati Domaj 210 banorë. Trajtohen me ndihmë ekonomike 33 familje.
- Fshati Pogaj 70 banorë. Trajtohen me ndihmë ekonomike 7 familje.
- Fshati Pusi Thatë 310 banorë. Trajtohen me ndihmë ekonomike 30 familje.
- Fshati Kishaj 200 banorë. Trajtohen me ndihmë ekonomike 32 familje.
- Fshati Myç Has 200 banorë. Trajtohen me ndihmë ekonomike 14 familje.

Njësia Administrative Gjinaj, ka një shkollë 9-vjeçare "Sinan Gjini", ku bëjnë mësim fshatrat Domaj, Gjinaj, Pusi Thatë dhe Myç Has.

Ka 2 kopshte, kopshti "Gjinaj" dhe kopshti "Domaj".

Infrastruktura e Njësisë Administrative Gjinaj është disi e pranueshme, ku problem mbetet rruga e pa asfaltuar.

Konkretisht rruga nacionale Gjinaj, për të cilën është hartuar edhe projekti për aslfaltim në vlerën 247, 449, 948.23 lekë.

Problem tjetër është dhe rruga Gjinaj-Domaj, e cila përditë e më shumë po bëhet e pakalueshme pasi përgjatë rrugës mungojnë kanalet anësore dhe turbinat.

Rruga Cahan-Kishaj është një problem tjetër.

Mungon komunikim i rrugëve të brendshme që lidhin lagjet me njëra-tjetrën.

Një problem tjetër është furnizimi me ujë i popullatës fshatrat (Gjinaj dhe Pusi Thatë).

Shërbimi shëndetësor në këtë njësi është në rritje, të gjitha fshatrat kanë ambulancë dhe personel të nevojshëm, si dhe një mjek i cili mbulon të gjithë fshatrat.

Qendra shëndetësore është Gjinaj.

Një problem për Fshatin Domaj është ndërtimi i rrjetit për kanalizimin e ujërave të zeza, për të cilën është hartuar projekti në vlerën 25, 132, 902.8 lekë.

Njësia Administrative Fajza

Njehsia Fajza përbëhet nga 8 fshatra, Fajza, Vranisht, Tregtan, Liken i Kuq, Metaliaj, Brenogë, Tobël, Sefoll me një popullsi prej 4366 banorësh,është një zonë me potencial të lartë rural, që mbështetet në bujqësi, blegtori dhe pasuri natyrore. Afërsia me kufirin me qytetin e kukës e bën një pikë lidhëse për zhvillim ekonomik dhe kulturor, ndërsa trashëgimia e saj kulturore ofron mundësi për turizëm rural e natyror.

Prioritetet Strategjike

1. **Zhvillimi ekonomik**
   - Modernizimi i bujqësisë dhe rritja e prodhimeve bio.
   - Forcimi i sektorit të blegtorisë dhe bletarisë.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS

- Nxitja e përpunimit të produkteve vendase.

2. **Infrastruktura dhe shërbimet**
   - Rehabilitimi i rrugëve dhe përmirësimi i aksesit.
   - Përmirësimi i furnizimit me ujë dhe kanalizimeve.
   - Investime në arsim dhe shëndetësi për cilësi më të lartë shërbimi.
3. **Turizmi dhe kultura**
   - Krijimi i itinerareve turistike rurale dhe natyrore.
   - Promovimi i trashëgimisë kulturore dhe kulinarisë lokale.
   - Nxitja e aktiviteteve kulturore që forcojnë identitetin lokal.
4. **Kapitali njerëzor dhe komuniteti**
   - Angazhimi i të rinjve dhe grave në iniciativat zhvillimore.
   - Mbështetje për organizatat lokale dhe nisma komunitare.

***Të gjitha projektet e njehsive janë të përmbledhura tek sektori i urbanistikës.**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS